



Kosova Initiative For Democratic Society
Iniciativa e Kosovës për Shoqëri Demokratike



E ARDHMJA NË BAST

Studim mbi arsimin e lartë në Kosovë

Prishtinë,

15 Nëntor 2002

Ky studim është përkrahur financiarisht nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme,
Instituti Ndërkombëtar për Hulumtime Paqësore në Oslo (PRIO) dhe Friedrich Ebert
Stiftung.

www.kids-kosova.org

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
Disa të dhëna mbi LOGO-n	3
Disa të dhëna mbi KIDS-në	4
Qëllimi i studimit	4
Historia e shkurtër e arsimit të lartë në Kosovë	4
PËRMBLEDHJA	5
REKOMANDIMET	7
I. LIGJI I ARSIMIT TË LARTË	10
Historiku i Ligjit	10
Diskutimet për Ligjin	10
II. REFORMAT NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS	12
Qëllimet e reformave	12
Procesi i reformës	14
Gjendja e tanishme në Universitet	14
Vazhdimi me reforma	15
III. METODOLOGJIA, LITERATURA DHE KUADRI MËSIMOR	16
Metodologjia	16
Literatura	18
Kuadri mësimor	18
IV. ADMINISTRATA DHE SHËRBIMI I STUDENTËVE	20
Funksionimi i administratës në fakultete	20
V. INFRASTRUKTURA	21
VI. PRANIMI I STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS	22
VII. FINANCAT	26
VIII. TREGU I PUNËS	28
IX. ARSIMI PRIVAT NË KOSOVË	30
X. MINORITETET NË SHKOLLIMIN E LARTË NË KOSOVË	32
XI. ORGANIZATAT E STUDENTËVE	34
XII. MARRËDHËNIET E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS ME UNIVERSITETET E TJERA	36
Aneksi A	
Anëtarët e Grupit për Zgjidhje Logjike	39

HYRJJE

Universiteti si institucion i edukimit të lartë ofron edukim superior për individët, të cilët dëshirojnë t'i përkushtohen karrierës profesionale, por gjithashtu ofron edhe kushte për kërkime shkencore si edhe shërbime të ndryshme për shoqërinë. Në një fazë të pasluftës dhe të transicionit të sistemeve, Universiteti i Prishtinës, sikurse edhe shoqëria kosovare, gjendet në udhëkryq. Pasi që Universiteti i Prishtinës është i vetmi institucion publik që ofron arsim të lartë në Kosovë, kjo do të thotë se edhe vetë e ardhmja e shoqërisë kosovare është në një lloj basti.

Kjo është aryesja që e shtyri Grupin për Zgjidhje Logjike – LOGO që ta bëjë një studim mbi këtë çështje.

Ky studim dhe rekomandimet e paraqitura më poshtë nuk rreflektojnë qëndrimet e Ministrisë Norvegjeze të Punëve të Jashtme, Institutit Ndërkombëtar për Hulumtime Paqësore (PRIO) dhe Friedrich Ebert Stiftung-ut.

Disa të dhëna mbi LOGO-n

LOGO (Grupi për Zgjidhje Logjike) është një projekt i organizatës joqeveritare “Iniciativa e Kosovës për Shoqëri Demokratike” (KIDS), i filluar në shtator të vitit 2002. Projekti tubon një ekip të rinjsh, të përkushtuar nga Kosova, me përgatitje të ndryshme, të cilët do të bëjnë hulumtime dhe do të shkruajnë mbi çështjet me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare. Qëllimi është që të nxiten debatet publike mbi këto çështje, duke u bazuar në hulumtim empirik dhe në analizë.

Arsyet e nisjes së këtij projekti janë të shumta. Gjatë viteve të pasluftës në Kosovë ka pasur zhvillime të ndryshme për të cilat vendimet janë marë në mungesë të plotë të debatit publik, kurse në raste të ralla veti kryesore e debateve të zhvilluara ka qenë mungesa e plotë e guximit qytetar, apo të atij intelektual. Një pjesë e madhe e këtyre vendimeve do të ndikojnë për një kohë të gjatë në jetën e kosovarëve. E vetmja dëshmi e shkruar mbi këto zhvillime dhe opinionin kosovar ndaj tyre janë artikujt e ndryshëm në gazeta si edhe aty-këtu ndonjë burim tjetër, shënime të cilat më shpesh kanë qenë vetëm deklarime të përgjithshme, madje ndonjëherë të pabazuara në fakte.

Një çështje tjetër është fakti se këto shënime dhe analiza mungojnë po ashtu edhe në qarqet ndërkombëtare. Disa nga gabimet dhe qasjet e gabueshme të bëra nga administrata ndërkombëtare në Bosnjë e Hercegovinë janë përsëritur edhe në Kosovë. Kjo na bën të konkludojmë sesa pak është mësuar nga gabimet e kaluara. Ekzistimi i një grupi të tillë vendës, siç është LOGO-ja, që do t'i analizojë çështjet dhe do të japë këndvështrimin vendës sigurisht se do ta ndihmojë këtë proces, do ta rrisë cilësinë e komunikimit dhe të kuptimit ndërmjet kosovarëve dhe ndërkombëtarëve. Gjë që do të ndihmonte edhe drejt përmirësimit të intervenimit të bashkësisë ndërkombëtare jo vetëm në Kosovë, por edhe në vatrat e tjera të krizës në të ardhmen.

LOGO-ja do të përpiqet ta bëjë këtë përmes publikimit të raporteve, të cilat do të studiojnë një varg çështjesh. Grupi nuk do të marrë qëndrime politike mbi këto çështje, por do të hapë debatin, duke i paraqitur faktet relevante, kontekstin dhe pastaj duke dhënë ide konkrete të bazuara në hulumtimin empirik dhe faktet e nxjerra. Raportet do të jenë të shkurtra, praktike dhe të orientuara në sugjerime strategjike. Kjo gjë do ta sigurojë një element të debatit publik në Kosovë që ka

munguar deri më tani. Prandaj do të jetë ndihmesë për krijuesit e politikave në institucionet kosovare, të cilët kanë përvojë të kufizuar qeverisjeje dhe që u nevojitet përkrahja me të dhëna mbi politikat e paanshme ashtu që të mund të marrin vendime të bazuara në informacion të mirë.

Disa të dhëna mbi KIDS-në

Iniciativa e Kosovës për Shoqëri Demokratike (KIDS) është një organizatë joqeveritare kosovare e themeluar në vitin 2000 me ndihmën e Institutit për Hulumtime Paqësore në Oslo (PRIO) dhe Akademisë Nansen në Lilehamer, Norvegji. Misioni i KIDS-së është që të krijojë hapësirë për diskutim mbi çështjet, siç janë: demokracia, transparencja, shoqëria civile etj. Aktivitetet kryesore të KIDS-së përfshijnë seminare, punëtori e debate mbi çështje të ndryshme me të cilat ballafaqohet sot shoqëria kosovare. Shumica e projekteve të KIDS-së janë të financuara nga Ministria norvegjeze e Punëve të Jashtme, përmes të Institutit për Hulumtime Paqësore në Oslo (PRIO).

Qëllimi i studimit

Edhe pse me një histori relativisht të shkurtër, por me shumë trazira, Universiteti i Prishtinës tani është duke u ballafaquar me një sfidë shumë të madhe, ndoshta më të madhen në historinë e vet. Pas shumë vitesh lufte për mbijetesën e vet kundër kërcënimeve të jashtme, Universiteti tani po ballafaqohet me nevojën e reformimit të brendshëm.

Në mënyrë që Universiteti i Prishtinës të arrijë standardin dhe cilësinë e nevojshme për shoqërinë kosovare do të duhej të punohej në shumë drejtime, si në reformimin përmbajtësor, ashtu edhe në formë. “E ardhmja në bast” shikon aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me arsimin e lartë, duke filluar nga ligji i ri, tentimet për reforma gjatë viteve të fundit,

infrastruktura, financat, tregu i punës, arsimit privat, shkollimi i minoriteteve e deri tek organizatat studentore. Dokumenti gjatë trajtimit të këtyre çështjeve shtjellon mundësitë e ndryshme dhe bazuar në analizë rekomandon zgjidhjet e mundshme.

Për qëllim të këtij studimi është bërë një hulumtim kuantitativ me studentë të Universitetit të Prishtinës (20-23 tetor 2002) si edhe një hulumtim cilësor (fokus grup) me mësdimdhënës në UP (5 nëntor 2002). Hulumtimi është bërë nga kompania Index Kosova në Prishtinë, partner me BBSS Gallup International.

“E ardhmja në bast” ka për qëllim që në këtë moment vendimtar për arsimin e lartë në Kosovë t’i analizojë dhe t’i ofrojë alternativat për përmirësimin e gjendjes. Qëllimi i LOGO-s është që përmes analizës së mirëfilltë, të bazuar në hulumtimin empirik, të publikojë studime që do të ndihmonin institucionet kyçe vendëse dhe ndërkombëtare për vendimmarrje mbi çështjen përkatëse. Në të njëjtën kohë, kjo ka për qëllim edhe nxitjen e debatit të shëndoshë publik mbi këto çështje.

Historia e shkurtër e arsimit të lartë në Kosovë

Institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë është Universiteti i Prishtinës i themeluar në vitin 1970. Deri nga fundi i viteve të nëntëdhjeta, kur u paraqitën edhe shkollat e para private, ka qenë edhe i vetmi institucion në Kosovë që ka ofruar këtë nivel të arsimit. Gjatë historisë së vet, Universiteti, sikurse edhe vetë shoqëria kosovare, ka kaluar nëpër disa transicione të mëdha, nga sistemi monist në ekonomi të tregut, nga aparteidi e lufta në një situatë me rrethana plotësisht të reja, në të cilat universiteti është e domosdoshme që të reformohet në mënyrë që t’i plotësojë nevojat e shoqërisë kosovare dhe të mbetet në hap me kohën.

Në Universitetin e Prishtinës mësimi mbahej në dy gjuhë kryesore: shqipe dhe serbe, por ekzistonte gjithashtu edhe një katedër në gjuhën turke. Kjo u mundësonte shqiptarëve t'i vijojnë studimet universitare në gjuhën amë, që edhe kishte qenë arsyeja kryesore e themelimit të universitetit. Universiteti i Prishtinës ka qenë shumë i suksesshëm, madje deri në vitin 1996 kanë diplomuar më shumë se 60,000 studentë, prej të cilëve 38,000 shqiptarë. UP-ja ishte në një mënyrë burim i jetës në Kosovë dhe ndihmoi shumë në ngritjen e saj.

Sfidimi i parë i serbëve ndaj studimeve në gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës filloi pas demonstratave të vitit 1981, të cilat serbët i shfrytëzuan për të propaguar se Universiteti i Prishtinës na qenka një vatër e nacionalizmit shqiptar që duhej shkatërruar. Në këtë mënyrë presionet ndaj UP-së vazhduan gjatë tërë dekadës. Gjatë kësaj kohe (1981 – 1990) numri i studentëve shqiptarë në UP u zvogëlua për 25 për qind. Kjo kulmoi me heqjen e autonomisë së Kosovës në vitin 1989, si pasojë e së cilës edhe filloi përndjekja më e madhe deri më tani kundër Universitetit të Prishtinës, më saktësisht studimeve në gjuhën shqipe. Në vitin 1991 kuadri mësimor dhe studentët shqiptarë u përjashtuan nga objektet e Universitetit të Prishtinës. Kjo i shtyu ata që ta vazhdojnë veprimtarinë nën hije, nëpër shtëpi private. Në të njëjtën kohë edhe financimi publik i arsimit në gjuhën shqipe në përgjithësi u ndërpre. Kështu, shqiptarët, me qëllim të vazhdimit të arsimit të tyre, organizuan sistemin vetjak të arsimit që nga të huajt u njoh si “sistem paralel”.

Edhe pse në kushte tepër të vështira, duke ndjekur mësimet nëpër shtëpi dhe në një formë ilegalityti, Universiteti i Prishtinës arriti që të mbijetojë dhe ishte njëri ndër simbolet më të spikatura të rezistencës kundër okupimit serb. Kushtet e vështira të mësimi dhe të vendosjes për studentë si edhe të stimulimit pothuajse inekzistent për mësimdhënësit, shkaktuan rënien e numrit të studentëve shqiptarë, mirëpo, me

gjithë këtar faktorë, Universiteti i Prishtinës në vitin 1996 kishte rreth 16,000 studentë.

Në ndërkohë, në objektet e Universitetit të Prishtinës kishte vazhduar mësimi në gjuhën serbe, tani me një numër shumë më të madh të studentëve në gjuhën serbe. Prej tyre shumica, 2/3 deri 3/4, ishin nga vise jashtë Kosovës (Serbia dhe Mali i Zi).

Gjatë viteve të nëntëdhjeta kishte disa tentime për të bërë një marrëveshje ndërmjet shqiptarëve dhe regjimit të Beogradit në mënyrë shqiptarëve që t'u lejohej kthimi në objektet shkollore. Marrëveshja e arritur me ndërmjetësimin e grupit “Sent Egjidio” me qendër në Vatikan, e nënshkruar në vitin 1996, parashihte hapjen e objekteve mësimore edhe për shqiptarët, mirëpo implementimi i saj nuk u realizua për shkak të obstrukcioneve nga pala serbe.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë (qershor i vitit 1999) shqiptarët u kthyen në objektet e Universitetit të Prishtinës. Universiteti i Prishtinës ishte një ndër institucionet e para që filloi punën në Kosovën e pasluftës. Tani Universiteti ballafaqohet me rrethana të reja të cilave duhet t'i përgjigjet. Me qëllim të zhvillimit të tij të mëtejshëm dhe afrimit sa më të madh me sistemet e arsimit në vendet e Perëndimit, shumë shpejt u ndërmorën iniciativa për reformimin e Universitetit të Prishtinës. Ky studim reflekton në këto përpjekje dhe analizon gjendjen aktuale në arsimin e lartë në Kosovë.

PËRMBLEDHJA

Sido që të shikohet: nga jashtë, nga brenda, nga perspektiva e mësimdhënësit, stafit administrativ, studentit, apo të një vizitori, lehtë shihet se Universiteti i Prishtinës nuk është në gjendje të mirë. “Si është krijuar kjo gjendje?” Përgjigjja ka të bëjë me një mori faktorësh me ndikim, të cilët mund të identifikohen nëse shikohen

vitet e nëntëdhjeta, koha e “shkollave-shtëpi”, mentaliteti i stafit udhëheqës dhe mësimdhënës, si edhe gjendja e krijuar pas “çlirimit” të Kosovës.

Me hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë mbretëronte një eufori, e përgjithshme, e cila zgjati një kohë tejet të gjatë, e ndihmuar nga shumë faktorë të jashtëm. Universiteti i Prishtinës dhe personeli i tij nuk mund të ishin imunë ndaj kësaj dukurie në vendin më optimistë në botë¹, kështu që me kthimin nëpër objekte u krijua përshtypja që u fillua nga aty ku mbeti UP-ja e viteve të tetëdhjeta², duke mos e marrë në konsiderim fare epokën e errët të dekadës së fundit të shekullit XX.

Nga ana tjetër, UNMIK-u emëroi administratorin ndërkombëtar të UP-së, Mihajl Daksner (Michael Daxner), i cili nuk kishte gjasa reale të arrinte që UP-së t’ia largonte sëmundjet që i kishte qysh nga fillimi, si edhe shumë të tjera që iu kishin krijuar në kohën e “shkollave-shtëpi”. Gjasat e Daksnerit u bënë edhe më të vogla me fillimin e sundimit të tij autokratik mbi Universitetin.

Tani, me largimin e Daksnerit, i mbetet Ministrisë së posakrijuar të Arsimit, Rektoratit të moçëm të UP-së dhe Unionit të Pavarur të Studentëve të stërpolitizuar në kërkim të bartin barrën e dhënies së rezultateve krahas pritjeve të mëdha të kosovarëve për të ardhmen e institucionit të tyre “më të çmueshëm”.

Me këtë studim, ne, Grupi për Zgjidhje Logjike – “LOGO”, dëshirojmë të hapim një debat në nivele të ndryshme të strukturave kosovare mbi të ardhmen e Universitetit të Prishtinës. Ne, hëpërhë,

nuk mendojmë se mund të bëhet ndonjë përparim substancial dhe i kënaqshëm në qoftë se nuk bëhen plane të detajizuara dhe në disa raste edhe radikale që të mund të zbuten pasojat e menaxhimit të dobët të UP-së gjatë viteve të kaluara.

Për këtë, Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës; Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara; strukturave udhëheqëse të UP-së; mësimdhënësve të UP-së; studentëve dhe organizatave studentore; organizatave ndërkombëtare dhe vendore që merren me çështjen e arsimit, ua drejtojmë këto rekomandime:

¹ Gallup International: “Kosova – the most optimistic country in the world”, January 2001 and January 2002.

² Gjatë viteve tetëdhjetë, UP-ja kalonte nëpër periudhën më të suksesshme të këtij institucioni shumë të rëndësishëm për Kosovën, atëbotë duke kaluar nëpër një situatë shumë të ndërlikuar politike, që do të përcaktonte përgjithmonë fatin e saj, në raport me Jugosllavinë e atëhershme.

REKOMANDIMET³

I. Ligji mbi arsimin e lartë

1. Duke pasur parasysh se mosnënshkrimi i Ligjit mbi arsimin e lartë nga ana e PSSP-së shkakton boshllëk ligjor në një moment thelbësor për zhvillimin dhe reformimin e arsimit të lartë në Kosovë, si edhe, nga ana tjetër, mund të krijojë pasoja politike në të ardhmen, **rekomandojmë që Ligji mbi arsimin e lartë, i miratuar më parë nga Kuvendi i Kosovës, të nënshkruhet nga Mihael Shtajneri.**

II. Reformat në Universitetin e Prishtinës

2. Në mënyrë që reformat eventuale t'u përgjigjen nevojave të Universitetit të Prishtinës, rekomandojmë të bëhet një vlerësim i kapaciteteve të kuadrit, trajnim shtesë i këtij kuadri dhe ripërtëritja e stafit mësimdhënës, edhe nëse kjo do të nënkuptonte largimin e një numri të madh të mësimdhënësve të moshuar dhe jo në hap me kohën.

3. Duke e vërejtur ngarkesën e madhe të shumë fakulteteve të UP-së me studentë dhe metodat joefikase të mësimdhënies, konsiderojmë se numri i studentëve në disa degë duhet të zvogëlohet në mënyrë të kujdesshme, për të krijuar një periudhë kohore afatmesme për rehabilitimin e universitetit.

4. Duke marrë parasysh se parimet e Deklaratës së Bolonjës janë duke u zbatuar me vështirësi në Universitetin e Prishtinës, rekomandojmë që të krijohet një grup punues që do t'i modifikonte reformat e propozuara për transformim sa më të lehtë të UP-së në një universitet me standarde evropiane.

III. Metodologjia, literatura dhe kuadri mësimor

5. Duke vërejtur mungesën e literaturës cilësore dhe të avancuar në Universitetin e Prishtinës, rekomandojmë përkthimin e literaturës së huaj, shfrytëzimin më të madh të literaturës bashkëkohore që përdoret nga universitetet e tjera shqiptare, si edhe unifikimin e terminologjisë shkencore për tekste universitare në gjuhën shqipe.

6. Duke vërejtur se në Universitetin e Prishtinës hëpërhë aplikohen metoda të vjetëruara të mësimi, të cilat nuk preferohen nga studentët, **rekomandojmë zbatimin e metodave mësi-more që preferohen nga studentët (puna në grupe, ligjërimi interaktiv, ushtrimet / seminarët, projektet / hulumtimet) që njëkohësisht janë metodat më bashkëkohore.**

IV. Administrata dhe shërbimi i studentëve

7. Duke marrë parasysh vështirësitë e paraqitura dhe joefikasitetin e administratës së dyfishtë, nëpër fakultete dhe në Rektorat, **konsiderojmë se duhet të krijohet një qendër informative në Rektorat, e cila do të ishte një shërbim kompjuterik me qëllim të informimit të zyrtarëve të administratës së fakulteteve për secilën imtësi.**

V. Infrastruktura

8. Duke marrë parasysh se gjendjaaktuale e infrastrukturës së Universitetit të Prishtinës nuk i plotëson tërësisht kushtet për zhvillimin normal të procesit mësimor, **rekomandojmë që të bëhet shfrytëzimi sa më racional i lokaleve të Universitetit, si edhe renovimi dhe riorganizimi i tyre.**

³ Rekomandimet janë të klasifikuara sipas kapitujve të këtij studimi

VI. Pranimi i studentëve në Universitetin e Prishtinës

9. Duke pasur parasysh problemet e krijuara në vitet e fundit në Universitetin e Prishtinës gjatë procesit të provimeve pranuese, **rekomandojmë që: në nivel të Rektoratit duhet të krijohet një trup punues, i cili do të merret ekskluzivisht me çështjen e provimit pranues. Ky trup do të duhej të studionte të gjitha sistemet e mundshme të provimeve pranuese, arsyeshmërinë dhe përshtatshmërinë e tyre me rrethanat në Kosovë.**

10. Me qëllim të ofrimit të një orientimi më të mirë, sa i përket fushës së studimeve dhe informatave të hollësishme mbi procesin e pranimit, **duhet të krijohet një shërbim këshillues që do të ishte në dispozicion të kandidatëve potencialë.**

VII. Financat

11. Duke marrë parasysh se Universiteti i Prishtinës nuk mund të jetë i vetëqëndrueshëm pa të hyra vetjake dhe se nuk mund të varet vetëm nga donacionet dhe Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, **rekomandojmë që të futet participimi i studentëve, përkatësisht pagesa e tyre për shkollimin që e marrin. Kjo do të ndikonte në zvogëlimin e numrit të studentëve, do të mundësonte ngritjen e nivelit të arsimit dhe përmirësimin e gjendjes materiale të mësimdhënësve.**

12. Duke e ditur se gjendja e rëndë sociale e shoqërisë kosovare mund të ndikojë që studentët, të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret për regjistrim, të mos kenë mundësi financiare për shkollimin e tyre, **konsiderojmë që të krijohen fonde të posaçme nga Qeveria e Kosovës, Universiteti dhe institucionet e tjera publike apo private të Kosovës për ndarjen e bursave për studentë të zgjedhur nga një komision i përzier qeveritar dhe universitar.**

VIII. Tregu i punës

13. Duke pasur parasysh se Universiteti i Prishtinës nuk i përmbush kërkesat dhe nevojat e tregut të punës në Kosovë për profile të caktuara, **kërkojmë që të bëhet profilizimi më efikas dhe më specifik i drejtimit të studimeve në Universitetin e Prishtinës.**

14. Për shkak të domosdoshmërisë që pas mbarimit të studimeve një i diplomuar të jetë i gatshëm të gjejë një punë dhe njëkohësisht të ketë së paku një përvojë praktike në fushën e caktuar, **rekomandojmë që studentëve t'u mundësohet ndjekja e punës praktike nëpër ndërmarrje publike apo private, në periudhë prej së paku gjashtë muajsh gjatë studimeve.**

IX. Arsimit privat në Kosovë

15. Duke pasur parasysh nevojën për disa profile të caktuara, të cilat mungojnë në Universitetin e Prishtinës, si edhe parashikimin se konkurrenca ndërmjet institucioneve arsimore do të shtonte cilësinë e punës, **rekomandojmë që Ministria e Arsimit dhe organet qeveritare të stimulojnë arsimimin privat nëpërmjet licencimit më efikas të institucioneve private dhe përkrahjes së tyre financiare.**

X. Minoritetet në shkollimin e lartë në Kosovë

16. Pasi që është synim i shoqërisë kosovare dhe i bashkësisë ndërkombëtare që ta zhvillojnë sistemin arsimor të Kosovës drejt standardeve të vendeve të Perëndimit dhe meqë kjo duhet të vlejë për të gjithë banorët e Kosovës, duke marrë parasysh faktin se për momentin, për, siç thuhet, shkaqe sigurie, nuk është e mundur që serbët të integrohen fizikisht në Universitetin e Prishtinës, atëherë rekomandojmë se duhet të bëhet integrimi formal në Universitetin e Prishtinës i katedrave në gjuhën serbe, të vendosura në

Mitrovicë. Kjo do t'i krijonte kushtet pastaj edhe për integrimin e tyre fizik në të ardhmen.

XI. Organizatat e studentëve

17. Duke marrë parasysh nevojën për depolitizim të Unionit të Pavarur të Studentëve, i cili do t'i linte më shumë hapësirë për t'u marrë ekskluzivisht me çështje të studentëve dhe të arsimit, **do të duhej të bëhet liberalizimi i organizimit të studentëve në Universitetin e Prishtinës. Kjo do të mund të bëhej nëpërmjet krijimit të organizatave të tjera studentore, të cilat do të zgjedheshin nëpërmjet votave të studentëve me një fushatë të rregullt dhe transparente dhe pastaj do të krijonin kuvendin dhe qeverinë e studentëve në Universitetin e Prishtinës.**

18. Duke u nisur nga përpjekjet e partive politike për të pasur ndikim në Unionin e Pavarur të Studentëve, si masë për depolitizimin e UPS-së mendojmë se do të ishte i udhës lejimi i krijimit të klubeve të partive politike në Universitetin e Prishtinës, bazuar në modelet e disa vendeve të Perëndimit.

XII. Marrëdhëniet e Universitetit të Prishtinës me universitetet e tjera

19. Duke u nisur nga nevoja e ngritjes së cilësisë së arsimit në hapësirën shqiptare, rekomandojmë që bashkëpunimi me universitetet shqiptare duhet të zgjerohet duke shikuar mundësi të reja për të bashkëpunuar, siç është shkëmbimi i kuadrit mësimdhënës si edhe i studentëve. Në një të ardhme të mesme, po ashtu, ky bashkëpunim do të mund të shikohej edhe për nga prizmi i specializimeve në fusha të caktuara të universiteteve të ndryshme shqiptare. Kjo qasje racionale do të mundësonte ngritjen e nivelit shkencor dhe teknologjik në qendrat përkatëse, të cilat pastaj studentët do të mund t'i shfrytëzonin për zhvillim më të lartë.

20. Bazuar në nevojën që kuadrot e specializuara në universitetet perëndimore të kthehen në Kosovë, kërkojmë që Qeveria e Kosovës të krijojë kushte për këta individë, duke paraparë një pjesë të buxhetit për përkrahjen e institucioneve të ndryshme shkencore në të cilat do të punonin e do të angazhoheshin këta individë. Këto institucione do të ishin edhe si një ndihmesë e madhe për qeverisjen e Kosovës në përgjithësi.

I. LIGJI I ARSIMIT TË LARTË

Ligji për Arsimin e Lartë është përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë - nga ekspertët e Këshillit të Evropës. Ky ligj është i pari ligj i hartuar në Evropë në frymën e Deklaratës së Bolonjës dhe, së këndejmi, ekspertët e konsiderojnë si një ndër ligjet më të avansuara për arsim të lartë në Evropë. Madje, ekspertët e konsiderojnë si ligjin më të mirë mbi arsimin e lartë në rajon. Mirëpo, çështja e këtij ligji lidhet me veçantinë politike të Kosovës. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, por nuk është nënshkruar nga PSSP Shtajner (Steiner), andaj ai nuk është në fuqi zyrtarisht, ndonëse Ministria e Arsimit e Kosovës, në disa fusha, ka filluar të punojë në bazë të këtij ligji.

Historiku i Ligjit

Historia e përpilimit dhe diskutimit të këtij ligji daton qysh nga koha e udhëheqjes me Universitetin e Prishtinës të administratorit të atëhershëm ndërkombëtar të Universitetit, Majkëll Daksner (Michael Daxner). Sipas zyrtarëve të lartë të UP-së, UNMIK-u dhe Daksneri, si përkrahës i krijimit të një universiteti për serbët në pjesën veriore të Mitrovicës, kishin ndërhyrë vazhdimisht në punën profesionale të ekspertëve të Këshillit të Evropës (KE) për të imponuar që në ligj të rregullohet edhe baza juridike për krijimin e një universiteti publik serb, të ndarë nga Universiteti i Prishtinës⁴. Pasi ishte rregulluar kjo çështje, Daksneri kishte kërkuar që ende pa u konstituar Kuvendi i Kosovës, në kohën e ekzistencës së KPA-së, të miratohej ky ligj. Ky ligj, në atë kohë

nuk u miratua dhe u shty deri në konstituimin e Kuvendit të Kosovës, për shkak të kundërshtimeve të palës shqiptare. Pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës, Ligji për Arsimin e Lartë u dorëzua për shqyrtim në Kuvend, nga i cili u miratua vetëm pasi u hoqën nenet që e rregullojnë ekzistencën e një universiteti serb në pjesën veriore të Mitrovicës⁵.

Mirëpo, edhe pse ky ligj si i tillë u miratua nga Kuvendi i Kosovës, ai ende nuk është nënshkruar nga PSSP Shtajner, duke krijuar kështu një boshllëk ligjor sa i përket çështjes së arsimit të lartë. Burime të Universitetit të Prishtinës theksojnë se Shtajneri ka pohuar se nuk do ta miratojë ligjin pa përfshirjen e një universiteti serb në pjesën veriore të Mitrovicës. Na bazë të Rezolutës 1244 dhe Kornizës Kushtetuese të Kosovës, PSSP-ja mund ta zhvleftejë secilin vendim të Kuvendit dhe në vend të tij të miratojë një ligj tjetër.

Diskutimet për Ligjin

Ligji i miratuar, ndonëse i standardeve të larta, ka hapësirë për t'u diskutuar. Në radhë të parë, organet e Universitetit të Prishtinës, janë konsultuar rreth përpilimit të tij, por vërejtjet e tyre janë marrë parasysh shumë pak. Zyrtarë të Universitetit, ndërkaq, nuk pajtohen plotësisht me një centralizim kaq të madh të kompetencave në duar të Ministrisë dhe me lënie shumë të vogël të kompetencave në duar të Universitetit e aq më pak në duar të fakulteteve. Centralizimi, kryesisht, ka të bëjë me sferën financiare, sferë kjo

⁴ Bisedë me Arsim Bajramin, prorektor i UP-së, më tetor 2002

⁵ Në versionin shqip që i është dorëzuar për miratim Kuvendit nga ana e Ministrisë, nuk figuronin nenet që e rregullonin juridikisht ekzistencën e këtij universiteti, derisa në tekstet serbisht dhe anglisht këto nene ekzistonin. Disa deputetë të Kosovës këtë e kanë konsideruar si një përpjekje perfide për ta miratuar këtë ligj, ndërsa zyrtarët ndërkombëtarë e kanë interpretuar si lëshim shtypi. Deputetët e Kuvendit, pasi e hetuan këtë anomali, e miratuan ligjin vetëm pas heqjes së pjesës që e rregullonte ekzistencën e këtij universiteti.

në të cilën Minsitria e ka fjalën kryesore. Në nenin 17, paragrafi 1 i Ligjit për Arsim të Lartë thuhet: “Ministria përcakton në një udhëzim administrativ metodologjinë që duhet zbatuar për caktimin e fondeve për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm”.⁶ Për krahasim, sipas statutit të Universitetit të Tiranës të miratuar në vitin 2000, fakultetet kanë autonomi financiare në raport me Universitetin. Kjo autonomi në sferën financiare u është dhënë fakulteteve për ta përmirësuar gjendjen materiale të profesorëve dhe për t’i stimuluar dhe motivuar ata më shumë për punë. Megjithatë, sipas Prof. Dr. Ylli Pangos, “kjo fitore e arritur me shumicë dërrmuese aso kohe, ekziston ende vetëm në letër dhe fakultetet e akademikët e nderuar edhe për të blerë naftë për makinat e tyre duhet të shkojnë t’i marrin tollonat në rektorat...”.⁷

Sipas Ligjit mbi Arsimin e Lartë, Statuti i UP-së duhet të përshtatet me ligjin dhe të jepet viza përfundimtare nga Minsitria dhe Kuvendi. Zyrtarë të universitetit, megjithatë, mendojnë se statuti aktual i UP-së duhet të ndryshojë shumë pak, për arsye se është i përpiluar në frymën e Deklaratës së Bolonjës dhe nga të njëjtit ekspertë që e kanë përpiluar edhe ligjin. Në pjesën që duhet të ndryshojë, sipas këtyre zyrtarëve, do të duhej të përfshihej edhe heqja e kompetencave të ish-administratorit ndërkombëtar që, sipas statutit aktual, ka kompetenca të pakufizuara, për të mos thënë autoritare.⁸

Është e diskutueshme nëse Kosova do të jetë e gatshme që ta zbatojë këtë ligj, duke pasur parasysh rrethanat e tanishme. Ky ligj mund të ngjajë që të rezultojë vetëm si një dekor i bukur, por realisht të mos ndryshojë përmbajtësisht gjendjen në arsim. Mund të krijohet shpërputhje në mes të gjendjes reale të arsimit tonë

(përfshirë edhe arsimin e ulët dhe të mesëm) dhe ligjit. Zyrtarë të lartë të universitetit konsiderojnë se do të ketë probleme në aplikimin e ligjit për një periudhë transitore 3-vjeçare dhe më pas zbatimi i tij do të jetë më i lehtë, sepse do të krijohen kushtet reale për zbatimin e tij të suksesshëm. Në bazë të hulumtimit kualitativ me mësimdhënës të Universitetit të Prishtinës del se në përgjithësi mësimdhënësit nuk janë edhe aq të informuar rreth ligjit mbi arsimin e lartë, e sidomos për përmbajtjen e tij. Megjithatë, qëndrimi i tyre ishte se është diçka pozitive që ekziston një ligj mbi baza të të cilit mund të punohet, gjë që nuk ka ekzistuar më herët.⁹

Universiteti i Prishtinës në vitet e para të themelimit të tij ka punuar në bazë të ligjeve të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ligje këto që nuk janë kompatible me sistemet bashkëkohore të arsimit që aplikohen në Perëndim.

Ligji i ri, ndërkaq, i shkruar në frymën e Deklaratës së Bolonjës, u paraprin zhvillimeve të reja në Evropë dhe, së këndejmi, e siguron përshtatshmërinë e sistemit të Arsimit të Lartë të Kosovës me atë të vendeve të Perëndimit.

Pengesa më e madhe, sa i përket ligjit, është mosmiratimi i tij nga ana e PSSP-së. Kjo e zvarrit reformimin e tërë sistemit arsimor në Kosovë dhe i lë të hendikepuar studentët, të cilët, tash për tash, janë duke i vazhduar studimet e tyre.

Ligjit i janë bërë edhe disa vërejtje të tjera teknike, kryesisht për aspektin gjuhësor në versionin në gjuhën shqipe¹⁰.

⁶ Ligji mbi Arsimin e Lartë, Neni 17.1, fq.30

⁷ Prof. Dr. Ylli Pango, Disa arritje në shkatërrimin e Universiteteve, Koha Jonë, 7.11.2002

⁸ Statuti i Përkohshëm i Universitetit, neni 7

⁹ Hulumtimi kualitativ me mësimdhënës të UP, kryer nga Index Kosova, nëntor 2002

¹⁰ Versioni në gjuhën shqipe i Ligjit mbi Arsimin e Lartë, sipas një testimi të bërë me programin elektronik të drejtshkrimit të shqipes, përmban disa qindra gabime të drejtshkrimit

II. REFORMAT NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Kur është dashur të aplikohet një reformë parëndimore pas mbajtjes së mësimit nëpër shtëpi¹¹, Universiteti i Prishtinës ka qenë i papërgatitur në aspektin material e financiar e edhe në atë kadrovik, thonë mësimsdhënësit gjatë një fokus grupi të mbajtur nga INDEX Kosova për nevojat e këtij studimi. Në të njëjtin hulumtim kualitativ, shikuar nga perspektiva e vitit 2002, profesorët thonë se nuk janë marrë parasysh e kaluara e Universitetit dhe pasojat e saj.

Qëllimet e reformave

Reformat në Universitetin e Prishtinës (UP) janë inicuar duke u bazuar në Deklaratën e Bolonjës, e cila është e obligueshme për të gjitha Universitetet anëtare të Konferencës së Rektorëve të Europës (CRE), ku Universiteti i Prishtinës ka asocuar me status të barabartë. Reformat kanë pasur qëllim¹²:

Reformimin e planeve dhe të programeve si dhe harmonizimin e tyre me ato të shteteve të Bashkësisë Evropiane si imperativ i kohës;

Përsosjen e planeve dhe të programeve ekzistuese dhe begatimin e tyre me përvojën e fakulteteve të ngjashme të BE-së;

Reformimin e regjimit të studimeve, hapjen e mundësive për transfer, pra këmbimin e studentëve;

Rritjen e efikasitetit dhe të cilësisë së studimeve nëpërmjet zbatimit të metodave bashkëkohore të ligjërimit dhe të vlerësimit të njohurive të studentëve;

Shfrytëzimin e potencialit kadrovik ekzistues dhe të atij që shkollohet në botën e jashtme; dhe

Lirimi i studentëve nga gjërat e tepërta dhe të panevojshme.

Duke i shikuar objektivat dhe duke i njohur, në një masë, rezultatet e diskutueshme të reformës së UP-së deri tash, mund të thuhet se nuk është marrë në konsiderim në masë të duhur një faktor shumë i rëndësishëm në tërë këtë – mësimsdhënësit dhe përgatitja e tyre për ndryshime.

Duke pasur parasysh ato që u thanë në hyrje të kapitullit, në lidhje me të kaluarën e UP-së, lehtë mund të thuhet se mësimsdhënësit në Universitet kanë metoda të stërvjetëruara të punës. Në këtë kontekst, nuk kanë qenë të rralla akuzat që i janë bërë UP-së nëpër medime, se UP-ja është Universitet i Mesjetës, madje ka pasur vlerësime se UP-ja do të duhej të mbyllej për disa vite. “Ne jemi duke u përpjekur që ta rregullojmë veturën, e cila është në ecje e sipër”, thoshte në fillim të mandatit të tij si administrator i Universitetit, Majkëll Daksner, për t’i pasqyruar përpjekjet për rregullimin e gjendjes në UP¹³.

Në mënyrë që reformat të nisnin mbarë, gjëja e parë që është dashur dhe ende mund të bëhet është të vlerësohen kapacitetet e kuadrit të UP-së për ta bërë Universitetin e Prishtinës kompatible me universitetet evropiane dhe për ta zbatuar barazvlerën me to. Përfundimisht, nuk ka dyshim se nevojitet një reformim i plotë i

¹¹ Prej vitit 1991 e deri në 1999, Universiteti i Prishtinës ka shfrytëzuar shtëpitë private për objekte mësimi, për shkak të dëbimit nga objektet e Universitetit nga ana e regjimit serb. Gjatë këtyre viteve niveli i studimit në Universitetin e Prishtinës ka qenë tejet i ulët.

¹² “Propozim i modelit të reformimit të Fakulteteve dhe Shkollave të Larta mbështetur në Deklaratën e Bolonjës”, 2001, Komisioni për Politikën Akadematike të UP-së

¹³ Intervistë me Majkëll Daksner, Koha Ditore, autor Bardh Rugova 2000.

kuadrove para se të fillohet me ndonjë reformë përmbajtësore në UP.


Reagimi i mësimit dhe i studentëve ndaj reformave

Në të gjitha intervistat individuale dhe hulumtimet kualitative me mësimit është përmendur një pasiguri tek mësimit më të moshuar që është paraqitur me propozimin e reformave.

“Aktualisht ka një tendencë në Universitet

fillimisht ndaj reformave të propozuara, si rezultat frike nga humbja e vendit të punës.

Si mekanizëm mbrojtës nga këto “rreziqe”, mësimit më me përvojë në Universitet gjithmonë kanë pasur të shprehur një masë të “kolegialitetit”, me ç’rast profesorët ia ruajnë pozitën njëri-tjetrit në UP. Një mësimit i ri i UP-së, gjatë intervistës thotë se kuadri vendimmarrës shpesh e arsyeton dhënien e gradave dhe të vlerësimeve pozitive



për shmangien e profesorëve, të cilët janë themelues dhe 10-vjet janë bartës të procesit mësimit, që është e dhimbshme, ngase shmangen nga procesi mësimit pa një kompenzim, pa një siguri të vogël materiale dhe, së dyti, mungojnë, po ashtu, fondet për një mbështetje të kuadrit të ri”¹⁴ thotë një mësimit në një fokus grup me kuadrin e UP-së. Këtu, si dhe gjatë intervistës individuale të mësimit, shihet qartë skepticizmi që është shprehur

mësimit, si një lloj ndihme. Nderkaq, populli ynë thotë: “e mira kthehet me të mirë”. Fryma e krijuar në UP si rezultat i kësaj dukurie e bën Universitetin që më shumë t’i ngjajë një institucioni social, sesa djetit të dijes së shoqërisë sonë.

Nderkaq, një reagim krejt tjetër ndaj reformave është bërë nga mësimit e rinj si dhe nga studentët, të cilët kanë qenë veçanërisht të interesuar për një frymë të re në UP dhe kështu e kanë pritur reformën me entuziazëm e, ndoshta, edhe me elemente euforie. Kjo, si duket, është pasojë e pakënaqësisë së tyre me gjendjen

¹⁴ “Arsimi i Lartë në Kosovë, roli dhe rëndësia” – hulumtim kualitativ: Fokus grup, Index Kosova, 2001.

dhe qëndrimin se çdo ndryshim është më i mirë se status-quo-ja e UP-së.

Procesi i reformës

Vërtet reformat kanë qenë më se të nevojshme në Universitet dhe, ndoshta, edhe reformat që janë zgjedhur do të mund të kishin pasur sukses, nëse do të ishin inkuadruar më shumë faktorë lokalë në procesin e hartimit dhe të zbatimit nga administratori ndërkombëtar, Majkëll Daksner (Michael Daxner)¹⁵.

Procesi i përcjellur i reformave të Universitetit të Prishtinës ka qenë fundamentalisht i gabuar, pasi që modeli i reformimit ka ardhur nga lart, kurse pjesëmarrja e subjekteve të Universitetit në të ka qenë afër me zeron. Reformat është provuar të implementohen furishëm në Universitetin e Prishtinës, gjë që e ka penguar zhvillimin e procesit të nevojshëm të shqyrtimit, testimit dhe modifikimit adekuat të tyre sipas nevojave të Universitetit të Prishtinës.

Mësimdhënësi i ri, të cilin e kemi intervistuar, tashmë i zhgënjyer në suksesin e reformave, si shumica e mësimdhënësve të tjerë në UP, thotë: “Daksneri, si sociolog, do të ishte dashur të jetë pak më empirik gjatë procesit të përpilimit dhe zbatimit të reformave”, duke aluduar këtu që (Daksneri) të zbresë poshtë nga “zyra e tij, lart në ndërtesën e Eksimkosit”.

Daksneri nuk ka qenë shumë i interesuar të veprojë bashkërisht me kuadrin udhëheqës dhe me mësimdhënësit e UP-së. Ekziston një lloj koncenzi tek mësimdhënësit se reformat “nuk duhet dhe as nuk mund të

bëhen vetëm nga një njeri”¹⁶. Megjithatë, thuhet se në anën tjetër, profesorët nuk kanë bërë asnjë përpjekje të paraqiten me propozime në lidhje me planet e Daksnerit e as t’i bashkohen në këtë proces, pasi që shumica e tyre, automatikisht janë radhatur në anë të kundërt, për shkak të skepticizmit fillestar.

Sa i përket procesit të reformimit, përfundimisht mund të thuhet se mosinkuadrimi i faktorit vendor në këtë proces ka sjellë shumë dëme në UP, por edhe mësimdhënësit dhe kuadri i UP-së kanë qenë tejet pasivë – të moshuarit, si rezultat i skepticizmit; të rinjtë për shkak të euforisë dhe disi, të dy palët kanë mbetur jashtë loje. Sa i përket Unionit të Pavarur të Studentëve se “sa është bërë që të kontribuohet në proces?”, në asnjë nga intervistat tona me mësimdhënësit mbi procesin e reformimit, UPS-ja nuk është përmendur. Mbase ka pasur punë “patriotike e gjithkombëtare” me prioritet gjatë asaj kohe.

Gjendja e tanishme në Universitet

Me gjithë pakënaqësitë që janë shprehur dhe ende shprehen nga kuadri dhe mësimdhënësit e UP-së, studentët duket të jenë më pozitivë në lidhje me reformat¹⁷. Megjithatë, kjo mund të jetë rezultat i zvoglimit të viteve të obligueshme për të diplomuar me reformën nga katër në tre vjet me sistemin 3+2+3. Ndërkaq, mësimdhënësit theksojnë një brengë të studentëve të tyre, të cilët me 3 vjet studimi (shkalla bachelor) nuk mund të jenë konkurrentë të denjë për vende pune karshi të diplomuarve nga sistemi i vjetër, pas katër vjetësh studimi.

Në të njëjtin hulumtim, pastaj, thuhet diçka që në një mënyrë jep vlerësim të kundërt

¹⁵ Personi bartës i procesit të reformimit të Universitetit të Prishtinës deri në largimin e tij nga posti me konstituimin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, në fillim të vitit 2002.

¹⁶ “Arsimi i artë në Kosovë, roli dhe rëndësia” – hulumtim kualitativ: Fokus grup, Index Kosova, 2001.

¹⁷ Hulumtim i opinionit publik me studentët e UP-së, Index Kosova, tetor 2002.

dhe, ndoshta, më të saktë se më lart, për shkak se përgjigjet janë më specifike - studentët thonë se metoda që përdoret më së shumti nga mësimdhënësit gjatë mësimit është metoda klasike ex-katedra (73%), pastaj janë ushtrimet/seminaret (47,5%), metodat interaktive (27%), puna ekipore/në grupe (22%) dhe më së paku përdoret, ose nuk përdoret fare si metodë - projektet/hulumtimet (2%). Në të njëjtën kohë, studentët preferojnë mu të kundërtën prej asaj që momentalisht më së shumti aplikohet si metodë e mësimit. Nga studentët më së shumti preferohet puna ekipore/në grupe (74%), pastaj metodat interaktive (59%), ushtrimet/seminaret (54%), projektet/hulumtimet (34%) dhe më së paku preferohet metoda klasike ex-katedra (6%).

Duket se metodat e reja të vlerësimit dhe notimit që janë duke u aplikuar në shumicën e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës kanë hasur në përkrahje nga ana e studentëve. Shumica e tyre (54,5%) shprehin se metodat e reja të notimit, në krahasim me ato klasiket, janë më të mira për matjen e dijes së tyre, derisa 8,5% mendojnë se këto metoda janë të njëjta me ato të vjetrat dhe vetëm 4,5% thonë se metodat e reja janë më të këqija se metodat klasike.

Çështja e metodave të vlerësimit dhe të notimit edhe më tej theksohet në rekomandimet e studentëve lidhur me atë se çfarë ndryshimesh reformuese duhet të bëhen nëpër fakultetet e tyre. Reforma e parë që rekomandohet nga studentët është çështja e provimeve, testeve dhe vlerësimit (43,2%), pastaj pasojnë ushtrimet, seminarat dhe puna ekipore (25,8%), ligjëratat interaktive (25,2%), marrëdhëniet ndërmjet mësimdhënësve dhe studentëve (20%), reformimi i kuadrit ligjërues (19,4%), të përcjella edhe nga kushtet e përgjithshme, infrastruktura, hapësira, literatura dhe shërbimi efektiv - organizimi më i mirë. Nga këto përgjigje mund të shihet se reformat nuk kanë prekur në masë të duhur çështjen e provimeve, të testeve dhe të vlerësimit në veçanti.

Pagesa apo regjistrimi i semestrit/vitit nga studentët është kategorizuar si problemi më i rëndësishëm me të cilin ballafaqohet fakulteti i tyre momentalisht. E ky problem është kategorizuar si i rëndësishëm edhe nga ana e mësimdhënësve me të cilët kemi biseduar, veçse studentët mendojnë se pagesa duhet të zvoglohet apo të hiqet, derisa mësimdhënësit e mendojnë të kundërtën.

Përfundimisht, për gjendjen e tanishme, shikuar nga jashtë dhe nga deklaratat e mësimdhënësve dhe studentëve, mund të konstatohet se reformat kanë ndryshuar disa gjëra, mirëpo me ç'sukses, nuk mund të thuhet me siguri.

Vazhdimi me reforma

Fillimisht duhet të bëhet një vlerësim i kapacitetit të mësimdhënësve për t'i bartur reformat; të bëhet trajnim shtesë i tij; dhe të ripërtrihet kuadri mësimor, si parakusht për përpilimin e reformave më të përshtatshme.

Pas këtyre hapave përgatitorë, ne mendojmë se duhet të krijohet një grup punues, që do të rishqyrtonte reformat e propozuara dhe problemet e paraqitura gjatë zbatimit të tyre dhe do të siguronte një transformim sa më të lehtë të UP-së në një universitet me standarde evropiane. Grupi punues duhet të rishikojë me një sy kritik Deklaratën e Bolonjës dhe ta ketë parasysh se UP-ja nuk duhet të jetë as universiteti i parë e as i fundit në Evropë që do t'i aplikojë parimet e Deklaratës së Bolonjës. Grupi punues duhet gjithashtu të marrë parasysh zbatimin e propozimeve të tyre në fakultete të veçanta, si pilot projekte.

Reformat e propozuara nga grupi punues duhet të kalojnë nëpër një proces të shqyrtimit të detajuar nga aktorë të ndryshëm në UP. Kjo do të siguronte participim sa më të madh të mësimdhënësve, stafit dhe studentëve në procesin e reformimit, gjë që do të

lehtësonte në një masë të madhe zbatimin e reformave eventuale.

III. METODOLOGJIA, LITERATURA DHE KUADRI MËSIMOR

Metodologjia, literatura dhe kuadri mësimor në Universitetin e Prishtinës nuk përkojnë gjithmonë me zhvillimet bashkëkohore të arsimit¹⁸. Ndërrimi i sistemeve nga ai monist në sistemin pluralist në Kosovë ka koiciduar me largimin e mësimdhënësve dhe studentëve shqiptarë nga objektet mësimore të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve nëntëdhjetë ka pasur shumë pak vend për përshtatjen e metodologjisë dhe të literaturës me kërkesat dhe të arriturat bashkëkohore, “prandaj edhe ka ndodhur


nuk kemi arritur më shumë se, siç kisha me thënë, të oportunizojmë në vend se të kemi shqyrtime kritike.”¹⁹

Metodologjia

Në bazë të hulumtimit kuantitativ të Index-Kosovës²⁰ shihet se studentët nuk janë edhe aq të brengosur me numrin e ligjëruesve të tyre dhe kriteret akademike e pedagogjike që i plotësojnë ata, sa janë të brengosur me metodat që aplikohen gjatë mësimin.

Në këtë kuadër u referohemi dy elementeve: metodologjisë së mësimdhënies dhe asaj të vlerësimit të dijes së studentit.

Momentalisht, nga ana e mësimdhënësve më së shumti përdoret metoda klasike, ex-katedra, ndërsa metoda më e preferuar, sipas studentëve, është puna ekipore/në grupe. Metoda e dytë për nga preferenca e



që në ligjrrat tona në Universitet nuk kemi arritur më shumë se të përsërisim mendime, nuk kemi arritur më shumë se të verbalizojmë, në vend se të meditojmë dhe

studentëve është metoda interaktive. Zbatimi i metodave të lartpërmenduar, të


¹⁸ Mendimi i tillë është shprehur në hulumtimin kualitativ me mësimdhënës të UP-së, të kryer nga kompania Index Kosova për nevojat e këtij studimi, më 5. 11. 2002 në Prishtinë.

¹⁹ Index Kosova – Fokus grupi me mësimdhënës me temën “Arsimi i lartë në Kosovë, roli dhe rëndësia”, zhvilluar në Prishtinë më 6.11.2000.

²⁰ Index Kosova – Hulumtimi kuantitativ me studentë, zhvilluar në Prishtinë 21-23 tetor 2002 (shih apendiksin 1).

cilat edhe preferohen më së shumti nga ana e studentëve, deri në një masë është vështirësuar për disa arsye: numri i madh i

subjektsh të barabartë. Sipas vetë mësimitdhënësve²², zakonisht mësimitdhënësi është perceptuar si bartës i



studentëve në disa fakultete dhe departamente të caktuara, mungesa e njohurive bazike nga ana e studentëve, si dhe vetë gatishmëria e studentëve për të participuar²¹. Në njërin anë, studentët këmbëngulin të zbatohen këto metoda, por shtrohet edhe pyetja se a janë edhe ata të gatshëm ta marrin barrën, e cila, padyshim, do t'u takojë, në qoftë se hyjnë në garë me mësimitdhënësit. Po ashtu, një metodë, e cila ka filluar të zbatohet viteve të fundit në shtetet e jashtme, por nuk është vënë re në UP, është puna në bashkësi (community service) me ç'rast studentët do të duhej të angazhohen në këtë fushë gjatë një semestri të caktuar. Kjo formë ka një kuptim edhe më të madh në rastin e Kosovës, ku i tërë shkollimi superior (si edhe pjesa tjetër e arsimit) është falas. Në këtë menyrë do të ngritej edhe vetëdija ndër studentët për investimin, të cilin shoqëria është duke e bërë në ta si dhe për nevojën e shpagimit ndaj së njëjtës.

Kualiteti i raportit ndërmjet studentëve dhe profesorëve është një element përcaktues i metodologjisë. Deri tash raporti mësimitdhënës-student nuk ka qenë raport

dijes, autoritetit dhe “pushtetit” në Universitet. Një raport i tillë, siç vërehet në praktikë, e cenon mendimin kritik gjatë orëve.

Në disa fakultete ligjëruesit nuk kanë konkurrencë, kjo është edhe një problematikë e lidhur me metodologjinë. Pra, kemi raste që profesorët kanë krijuar një lloj monopoli faktik. Kjo gjë vështirëson edhe zbatimin e çfarëdo ndryshimi në metodologjinë e mësimitdhënies.

Sa i përket sistemit të vlerësimit në UP, ai është i bazuar në gradat (notat) nga 5 deri në 10, me ç'rast 5 është notë e pamjaftueshme, ndërsa nota 10 paraqet notën më të lartë. Sipas anketave, 43 përqind të studentëve mendojnë se metodat e vlerësimit janë çështja e parë, të cilën ata e rekomandojnë për reformë²³.

²² Index Kosova – Hulumtim kualitativ me mësimitdhënës në UP, zhvilluar më 5.11.2002 në Prishtinë.

²³ Index Kosova – Hulumtimi kuantitativ me studentë – zhvilluar më 21-23 tetor 2002 në Prishtinë.

²¹ Shih më lart

Literatura

Një ndër hendikepet më të mëdha në punën e UP-së, përpos vështirësive financiare, është edhe mungesa e literaturës. Madje, sipas studimit të kompanisë Index Kosova, ky problem renditet nga ana e studentëve si problemi i dytë për nga rëndësia²⁴. Një kohë të gjatë në këtë institucion ka ekzistuar qëndrimi se çdo profesor duhet ta shkruajë tekstin për lëndën, të cilën e ligjëron. Mësimi nga teksti i profesorit është konsideruar - dhe ende konsiderohet - parakusht për ta dhënë provimin me sukses. Madje, në disa raste edhe më ekstreme, për shkak të mosmarrëveshjeve personale ndërmjet ligjëruesve të së njëjtës lëndë, studenti është ai, i cili pëson pasi që ka shfrytëzuar tekstin e “anatemuar” nga njëri apo ligjëruesi tjetër. Shpeshherë, në vend të literaturës së mirëfilltë, profesorët u ofrojnë studentëve shënime, në bazë të së cilave kanë ligjëruar vite të tëra.

“Fatkeqësisht, ka ende pedagogë në UP që u japin studentëve shënime të ndryshme dhe të tillë që përdorin literaturë të viteve të 50-ta dhe të 60-ta”²⁵.

Përpos ngecjes në planin e të arriturave më të reja shkencore, kjo traditë sa i përket literaturës, shpesh ka pasur edhe pasoja të tjera negative. Një ndër to është se profesorët me kualitete të dobëta profesionale kanë qenë të obliguar²⁶ ta nxjerrin tekstin e vet, gjë që ka lënë pasoja shumë negative, ndonjëherë për gjenerata të tëra. Siç duket, përfituesit më të

mëdhenj në tërë këtë situatë janë pronarët e skriptoreve (fotokopjeve) të ndryshme, në të cilat mund të gjenden edhe fosile të vërteta, tekste të stërvjetruara, të cilat vite të tëra ka që nuk gjenden në qarkullim, por janë të domosdoshme për studentët, të cilët dëshirojnë të kenë sukses në studimet e tyre.

Njëra ndër zgjidhjet e mundshme të këtij problemi është përkthimi i literaturës së huaj, e cila në disa raste është shumë më e avancuar sesa ajo që momentalisht përdoret. Nga hulumtimi kualitativ me mësimdhënës del se ata pajtohen që parimisht Universiteti i Prishtinës duhet t’u ofrojë studentëve literaturë në gjuhën shqipe, por nuk do të thotë që kjo literaturë të jetë e autorëve shqiptarë²⁷. Në të kaluarën janë shfrytëzuar përkthimet nga gjuha serbe (në disa raste përkthimi i dytë nga gjuha origjinale), por sot, kjo më nuk bëhet. Ndërkaq, këto përkthime, gjithnjë e më shumë, janë duke u zëvendësuar nga përkthimet e Tiranës, të cilat janë duke e mbushur këtë hapësirë. Mirëpo, edhe në këtë fushë ka probleme, pasi që terminologjia që shfrytëzohet në këto përkthime ndonjëherë është plotësisht jokompatibile me atë që përdoret në tekstet e UP-së, gjë që krijon vështirësi serioze në të kuptuarit e tekstit.

Problematika e literaturës, pa dyshim, është e lidhur ngusht edhe me ngecjen në zhvillimin dhe krijimin e kuadrit cilësor mësimor.

Kuadri mësimor

Të përballur me pagat e vogla, të cilat i ofron Universiteti i Prishtinës si njëri nga shërbimet publike të vendit, një pjesë e madhe e kuadrove kualitative të universitetit janë të shtyrë që të angazhohen në punë dhe projekte të tjera, të cilat sjellin përfitime financiare shtesë.

²⁴ Shih më lart

²⁵ Index Kosova – Hulumtimi kualitativ me mësimdhënës të UP, zhvilluar më 5.11.2002 në Prishtinë.

²⁶ “Ka qenë një kohë një qëndrim që secili profesor duhet ta shkruajë tekstin e vet. Ky qëndrim u konsiderua si absurd për faktin se edhe arsimtarët me cilësi të dobëta profesionale kanë qenë të obliguar që ta nxjerrin tekstin e vet” – citat nga Hulumtimi: “Arsimi i lartë në Kosovë, roli dhe rëndësia”, zhvilluar nga Index Kosova, më 6.11.2000, në Prishtinë.

²⁷ Index Kosova – Hulumtimi kualitativ me mësimdhënës të UP, zhvilluar më 5.11.2002 në Prishtinë.

Kjo bën që përqëndrimi i tyre në procesin e mësimin të jetë më i vogël²⁸.

Numri i kuadrit mësimor të UP-së është përafërsisht 1208, prej të cilëve rreth 50 për qind kanë tituj të ndryshëm shkencorë²⁹. Një mësimdhënës në UP gjatë punës së tij të përditshme përballet me probleme të natyrës së ndryshme: paga e ulët, investimet e pakta në infrastrukturë, amfiteatrot e stërngarkuara, pasiguria sociale, etj. Pos kësaj, nuk ekziston as stimulimi nga ana e shoqërisë në këtë aspekt dhe mësimdhënësi, sot, përballet me një erozion të prestigjit shoqëror, të cilin e ka pasur në të kaluarën ky profesion. Sa i përket përkrahjes nga instucionet, vetëm në vitet e fundit ka filluar një përkrahje më e organizuar e ngritjes dhe e avansimit të njohurive dhe kualitetit të kuadrit mësimdhënës, ndryshe nga dekada e fundit, kur çdo përpjekje për avansim profesional apo shkencor është financuar nga vetë mësimdhënësi.

Një dukuri, e cila vërehet në mesin e kuadrit mësimdhënës në UP është edhe ngathtësia në fushën e zëvendësimit të kuadrit, i cili në njërin apo mënyrën tjetër nuk i ka përmbushur standardet e caktura. Kjo ka mbetur si pasojë nga e kaluara e afërt, kur qëllim kryesor ka qenë mbijetesa e UP-së, e jo edhe përzgjedhja e mirëfilltë e kuadrit shkencor. Në këtë kuadër, preferohet një fleksibilitet më i madh, pasi që kohët e ndryshme, kërkojnë njerëz të ndryshëm.

“Kohët ndryshojnë dhe ato kërkojnë njerëz të ndryshëm. Tash, kur jemi në prag të reformave, duhet që kuadrot të zgjedhen me kritere të tjera, duhet që ata të jenë me frymë të reformave, me shpirt reformator.”³⁰

Mirëpo, kjo problematikë ndërlidhet edhe me pasigurinë sociale, me të cilën ballafaqohet shumica e mësimdhënësve, të cilët janë në prag të pensionimit.³¹ Kështu që në fillim të nismës për reforma, një pjesë e madhe e energjisë dhe e kohës është shpenzuar për sigurimin e numrit të duhur të studentëve për një lëndë apo të orëve për mësimdhënës, në mënyrë që mësimdhënësit të mos mbeten pa punë, në rast se nuk e plotësojnë kuotën e nevojshme (20 studentë për një ligjërues)³². Njëherësh, mungojnë fondet për mbështetjen e kuadrit të ri. Nga praktika e deritashme është treguar se për krijimin e kuadrit të ri në UP nevojitet një kohë e gjatë, me ç'rast një ndër arsyt mund të jetë edhe sistemi i ndërlikuar, të cilit ata duhet t'i nënshtrohen. Është e preferueshme që në të ardhmen të bëhet hartimi i standardeve dhe zbatimi i përpiktë i tyre, standarde të cilat do të shfrytëzoheshin gjatë emërimit të kuadrit në UP. Në këtë rrafsh, do të ndihmonte edhe koordinimi me shoqatat e ndryshme shkencore dhe profesionale (Shoqata e Historianëve, e Mjekëve, e Juristëve), të cilat do të ndihmonin dhe ofronin edukim shtesë, programe për rikualifikim dhe përgatitje të tjera për kuadrin mësimor. Këto shoqata/asociacione, së bashku me

²⁸ “Një gjë tjetër që ndikon shumë, jo vetëm në prodhimin e literaturës, por edhe në procesin mësimor në përgjithësi, është fakti se profesorët nuk janë fizikisht në universitet. Shumica e tyre punojnë në vende të ndryshme të punës, përveç në fakultetet e tyre, sepse ata shkojnë në fakultetet e tyre vetëm kur i kanë afatet e caktuara për ligjërata ose provime, dhe kjo do të thotë se ata nuk janë aty me tërë qenien e tyre” – citat nga Hulumtimi kualitativ me mësimdhënës të UP, i zhvilluar nga Index Kosova më 5.11.2002 në Prishtinë.

²⁹ “Current Conditions in the University of Prishtina”, studim i kryer nga kompania Index Kosova në vitin 2001.

³⁰ Hulumtimi kualitativ me mësimdhënës të UP-së: “Arsimi i lartë në Kosovë, roli dhe rëndësia”, kryer nga kompania Index Kosova, 6.11.2000, në Prishtinë.

³¹ Sipas Ligjit mbi Metodologjinë për përcaktimin e nivelit të pensionit themelor në Kosovë dhe caktimin e datës së fillimit të dhënies së pensionit themelor, miratuar nga Kuvendi i Kosovës në Qershor 2002, i cili cakton pensionet në vlerë prej 28 Euro.

³² Hulumtimi kualitativ me mësimdhënës të UP-së: “Arsimi i lartë në Kosovë, roli dhe rëndësia”, kryer nga Index Kosova, 6.11.2000, në Prishtinë.

fakultetet, të cilat i përkasin fushës së njëjtë akademike, duhet të krijojnë një metodë të vlerësimit, sipas të cilës çdo seminar në të cilin ndonjë mësimitdhënës do të merrte pjesë (pa marrë parasysh si panelist apo dëgjues) do t'i siguronte atij një numër të caktuar pikësh që do të merreshin parasysh gjatë konkurrimit për pozitën e re. Në këtë mënyrë do t'i jepej një shtytje edhe kërkimeve shkencore në kuadër të UP-së si dhe do të stimulohej kuadri mësimit. Megjithë këto vështirësi, me të cilat përballet kuadri i UP-së si dhe të metat e lartpërmendura, shumica e studentëve (74,5%) mendojnë se ligjëruesit e tyre i plotësojnë kriteret akademike dhe pedagogjike për ligjërime, ndërsa numri i atyre, të cilët nuk pajtohen me këtë qëndrim është më i vogël (25,5%)³³.

IV. ADMINISTRATA DHE SHËRBIMI I STUDENTËVE

Administrata e Universitetit të Prishtinës ka pësuar pak ndryshime përmbajtësore pas kthimit në objektet universitare, ndërsa janë bërë disa ndryshime kompetencash dhe hierarkie.

Me emrin administratë të universitetit nënkuptohen të gjitha shërbimet jashtëmësimore në Universitet, që nga shërbimet administrative të studentëve, deri te shërbimet për kuadrin mësimit.

Hierarkia e administratës, nis nga rektorati³⁴, për të vazhduar me dekanatet e

fakulteteve dhe shërbimet e tjera të fakulteteve.

Universiteti i Prishtinës funksionon me sistem centralist, gjë që përfshin edhe centralizimin e administratës³⁵.

Funksionimi i administratës në fakultete

Administrata e fakulteteve nis me shërbimin e studentëve. Me këtë shërbim realizohen: dorëzimi i dokumenteve për të marrë pjesë në provimin pranues në fakultet; dorëzimi i dokumenteve për t'u regjistruar në fakultet; regjistrimi i kandidatëve, paraqitja e provimeve; verifikimi i notës së marrë, marrja e certifikatës në vend të diplomës, marrja e diplomave si dhe lëshimet e vërtetimeve të ndryshme, lëshimi i vërtetimeve për mungesë në punë, plotësimi i librit amzë dhe i kartonit të studentëve.

Në disa fakultete, administrata ende është duke funksionuar në mënyrë mekanike, pa kompjuterë, kështu që shumica e shënimeve mbahen me dorë. Në disa fakultete tjera, siç është ai i Shkencave Matematiko-Natyrore, shënimet mbahen nëpërmjet kompjuterit dhe programeve të caktuara e të posaçme për administratën e studentëve. Sipas punëtorëve të administratës, puna me kompjuter e lehtëson shumë punën e mbajtjes së shënimeve. Mirëpo, shumica e punëtorëve të administratës së tanishme, si punëtorë që edhe më herët kanë punuar në atë vend pune, janë kryesisht njerëz të vjetër, pa kualifikime të punës me kompjuter³⁶.

Kryesisht, për një punëtor të shërbimit të studentëve, janë 500 – 700 studentë. Në Fakultetin e Filologjisë, punojnë 3

³³ Index Kosova – Hulumtimi kuantitativ me studentë – zhvilluar më 21-23 tetor 2002 në Prishtinë.

³⁴ Para lufte sistemi administrativ nuk ka qenë i centralizuar, por me insistimin e Daksnerit është bërë edhe centralizimi i administratës së Universitetit, gjë që nënkupton një sistem hierarkik të vendosjes që nis nga rektorati, e jo nga dekanatet, siç ka qenë më herët.

³⁵ Statuti i përkohshëm i Universitetit të Prishtinës, 23.10.2000.

³⁶ Intervistë me Demë Fetajn, shef i shërbimit të studentëve në Fakultetin e Filologjisë (realizuar në tetor 2002).

punëtorë, për t'i kryer shërbimet e afër 2000 studentëve të këtij fakulteti.

Me punën e shërbimit të studentëve, studentët, kryesisht, nuk janë të kënaqur – 48 për qind të të anketuarve janë të pakënaqur, ndërsa 47 për qind janë të kënaqur me shërbimin. Kryesisht janë të kënaqur studentët e vitit të parë, ndërsa pakënaqësia e tyre rritet me vazhdimin e studimeve të tyre.

Arkivet, poashtu, mbahen në fakultete³⁷.

Në administratën e fakulteteve pos shërbimit të studentëve, shërbejnë edhe referenti për mësim që merret me udhëheqjen e dokumentacionit të mësimdhënësve - si kontratat e punës e të ngjajshme - referenti i studimeve pasuniversitare, sekretari, shefi i kontabilitetit, arkivisti, arkëtari i studentëve dhe dekanati.

Shumë rrallë në fakultete vëhen shpalljet e planeve të punës, ndërsa komunikimi me studentë nuk bëhet përmes ndonjë informatori, por studentët detyrohen të pyesin në shërbimin e studentëve.

Momentalisht, shërbimet e administratës, kryesisht, duhet të shkojnë përmes administratës qendore. Kjo bën që të ekzistojnë njëkohësisht dy administrata që mund ta pengojnë njëra-tjetrën. Administrata e fakulteteve i pranon kandidatët, ndërsa regjistrimi i tyre bëhet në administratën qendrore të rektoratit. Kjo ka bërë që dy muaj pas fillimit të vitit shkollor (2002\2003) të vonohet dhënia e indekseve për studentët e rinj, të regjistruar sivjet. Më herët, indeksët (librezat e studentëve) janë dhënë shumë më shpejt.

Përmirësimin e kësaj gjendjeje do ta ndihmonte formimi i një qendre informative në rektorat në vend të administratës së dyfishtë. Ky shërbim do

t'i informonte si nëpunësit e administratës, ashtu edhe studentët mbi secilën imtësi që ka të bëjë me çështjet e studimeve.

V. INFRASTRUKTURA

UP-ja, momentalisht, për zhvillimin e procesit mësimor është duke i përdorur 37 objekte³⁸, prej të cilave 30 gjenden në Prishtinë dhe janë të shpërndara në pjesë të ndryshme të qytetit. Gjendja në të cilën janë këto objekte nuk është shumë e mirë, pasi që pjesa më e madhe e tyre ka nevojë për investime shtesë me qëllim të renovimit adekuat. Një valë e renovimit të ndërtesave ka filluar dhe ka përfunduar në shumicën e fakulteteve gjatë viteve 1999 dhe 2000. Mirëpo, mungojnë mjetet e mjaftueshme financiare që do t'i plotësonin të gjitha kërkesat, në fushën e infrastrukturës, të cilat dalin si rezultat i numrit të madh të studentëve dhe të kuadrit mesimor³⁹.

Numri i kompjuterëve në përgjithësi është ende i vogël (1 kompjuter për 55 studentë dhe 1 kompjuter për 4 mësimdhënës apo punëtorë të administratës)⁴⁰. Numri më i madh i kompjuterëve gjendet në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore (gjithsej 57)⁴¹. Rritjes së numrit të kompjuterëve dhe të aparaturave të tjera përcjellëse dukshëm i kanë ndihmuar donacionet nga organizatat dhe fondacionet e ndryshme siç janë: WUS-Austria, Qeveria e Gjermanisë, Universiteti i Gracit, Unioni Evropian, Universiteti i Lidsit, GTZ, Fondacioni SOROS etj. Sa u përket depërtimit dhe përdorimit të internetit në UP, përparimet më të mëdha janë shënuar gjatë viteve

³⁷ Në bazë të rregullave dhe ligjeve të vjetra, do të duhej që Arkivi Qendror i Kosovës të vinte çdo dhjetë vjet e t'i merrte këto dokumente të arkiveve të fakulteteve, por kjo nuk ka ndodhur as para luftës, e nuk ndodh as tash.

³⁸ Current Condition of the University of Prishtina – Index Kosova, 2001

³⁹ Ibid.

⁴⁰ Ibid.

⁴¹ Ibid.

2000 dhe 2001, duke iu falënderuar angazhimit të OJQ-së IPKO, e cila ka ofruar shërbime falas për një kohë të caktuar për 5 fakultete në kuadër të UP-së.

Sipas hulumtimit kuantitativ të INDEX Kosova, ekzistojnë mendime të ndryshme rreth çështjes së hapësirës së mjaftueshme dhe adekuate, e cila nevojitet për zhvillimin normal të procesit mësimor. Rreth një e treta e studentëve mendojnë se fakulteti i tyre ka hapësirë të mjaftueshme dhe adekuate për zhvillim normal të procesit mësimor. Ndërkaq, rreth një e treta mendon se kjo hapësirë në fakultetin e tyre është e mjaftueshme, mirëpo nevojitet ose riorganizimi i saj, ose renovimi i saj. Gjithashtu, ekziston edhe një pjesë mjaft e madhe e studentëve (32,5%) që është absolutisht e pakënaqur me hapësirën, duke thënë se hapësira e fakultetit të tyre nuk është as e mjaftueshme e as adekuate për zhvillim normal të procesit mësimor. Megjithkëtë, shumica e studentëve (68%) deklarojnë se fakulteti i tyre i shfrytëzon në mënyrë racionale lokalet që i posedon, ndërsa 26% të studentëve thonë se fakulteti i tyre nuk i shfrytëzon në mënyrë racionale lokalet e veta.

Përveç klasave të mësimi, studentët në fakultete të ndryshme të Universitetit të Prishtinës i shfrytëzojnë edhe llojet e tjera të hapësirës për ta mbajtur mësimin. Prej të gjitha lokaleve të tjera, për mbajtjen e mësimi më së shumti shfrytëzohen amfiteatrot (71,5%), pastaj labororet (33,5%), kabinetet (33%), klinikat (9,5%) dhe shumë më pak atelietë, palestrat dhe bibliotekat. Shumica e studentëve deklarojnë se këto hapësira janë deri diku të pajisura dhe deri diku jo të pajisura, ndërsa vetëm 8,2% e tyre thonë se këto hapësira nuk janë fare të pajisura⁴².

Përpos problemeve të lartpërmendura, Universitetin e rëndon gjendja e rëndë

⁴² Hulumtimi kuantitativ me studentë në UP, zhvilluar më 20-23 tetor 2002 në Prishtinë nga Index Kosova.

ambientale në hapësirën e tij, siç e rëndon edhe mungesa e higjienës⁴³.

Pa dyshim, adoptimi, renovimi dhe riorganizimi i hapësirës mund të ndikojnë shumë në efikasitetin e punës dhe të studimit në Universitet.

VI. PRANIMI I STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Vetëm numri i maturantëve në Kosovë në vitin 2000/2001 ka qenë i barabartë me numrin e përgjithshëm të studentëve në Universitetin e Prishtinës. Bazuar në këtë, mundësitë që këta të regjistrohen në ndonjë fakultet dhe ta vazhdojnë shkollimin e tyre në Kosovë dalin shumë të vogla⁴⁴. Konkurrenca në disa fakultete është aq e madhe, sa që 10 kandidatë konkurrojnë për një vend. Kjo e bën procesin e pranimit në universitet, çështje të ballinave të gazetave.

Nevoja për studimin e mundësive për të përmirësuar procesin e pranimit është më se e evidente. Kjo do të ndikonte që kualifikimi i kandidatëve për studim në universitet të bëhet në mënyrë më të drejtë si dhe që kualiteti i rezultateve të punës së universitetit të shtohet.

Çështja e provimeve pranuese në Universitetin e Prishtinës gjithmonë ka qenë temë e nxehtë e përcjellur me shumë kundërthënie dhe ka ndikuar shumë në

⁴³ “Ambientet e çdo fakulteti janë turp për çdokë, ajo çka ndodh është e tmerrshme”- “Arsimi i lartë në Kosovë, roli dhe rëndësia” – Index Kosova, 06.11.2000, Prishtinë.

⁴⁴ D. Pupovci, H. Hyseni, J. Salihaj, Arsimi në Kosovë 2000/2001, botimi shqip, Prishtinë, dhjetor 2001.

krijimin e reputacionit të Universitetit - e sidomos të disa fakulteteve - si institucion i korruptuar.

Rastet e përfolura për shkelje të mëdha në të kaluarën janë të shumta. Deri vonë, Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës ka qenë mjaft i përfshirë në këtë, e kjo, sigurisht, për shkak të interesimit shumë të lartë për këtë fakultet. Një rast karakteristik ka qenë provimi pranues për Fakultetin e Mjekësisë në vitin 1996, kur prej 100 studentëve sa ishte planifikuar të pranoheshin, në fund u pranuan mbi 250. Në atë kohë, edhe pse u përfol shumë, ky rast nuk u shqyrtua më thellësisht dhe nga udhëheqësia e atëhershme e fakultetit nuk u kërkua përgjegjësi.

Ky rast dhe shumë raste të tjera të ngjashme kanë ndikuar shumë që imazhi i universitetit, e sidomos ai i Fakultetit të Mjekësisë të dëmtohet shumë. Akuzat e shumta për nepotizëm, korrupsion me para, kanë qenë të vazhdueshme, mirëpo asnjë rast nuk është ndriçuar zyrtarisht.

E gjithë kjo për pasojë ka pasur mbingarkesën e mësimdhënësve me studentë dhe rënien e kualitetit të punës. Në shumë raste studentët e regjistruar në mënyrë të çrregullt (“me të njofshëm” siç përdoret termi për këtë dukuri) janë shumë të paimterësuar për të vijuar studimet rregullisht dhe nuk kanë nivel të aftësive për ta studiuar lëminë përkatëse. Ky është një faktor që qartazi ndikon në rënien e numrit të studentëve në mënyrë progresive ne raport me ndjekjen e studimeve nga viti në vit⁴⁵.

Një efekt i tillë është edhe më negativ, kur të merret parasysh numri i studentëve të regjistruar, të cilët i përfundojnë studimet. Ky numër është në disproporcion të madh me numrin e studentëve të regjistruar. Kjo i kushton dhe do t'i kushtojë shoqërisë kosovare në të ardhmen. Nëse marrim shembullin e Fakultetit të Mjekësisë si

institucionin kryesor për prodhimin e kuadrove mjekësore, profesionale dhe nivelin e prodhimit të kuadrit nga ky fakultet, dhe pastaj këtë numër e krahasojmë me nevojat e popullatës, sipas standardeve të Organizatës Botërore Shëndetësore (kuadër mjekësor për kokë banori), do të na duhen edhe 30 vjet për ta arritur numrin e mjaftueshëm të kuadrit mjekësor.⁴⁶

Nga kjo del se mënyra e seleksionimit të studentëve luan një rol shumë të madh në kualitetin e studentëve dhe të mësimdhënies. Kjo pastaj ndikon në rezultatet e arritura në fakultet dhe plotësimin e nevojave të Kosovës. Një përzgjedhje e gabueshme do të ketë ndikim negativ në gjithë këtë.

Në vitet e para pas lufte, me nismat e shumta për reforma, u krijua një shpresë se kjo dukuri do të zhdukej. Mirëpo, gjërat të cilat janë aq thellë të rrënjësura në sistem, është vështirë të ndërrohen.

Shembulli më i ri i paqartësive, mungesës së standardeve, mungesës së përgjegjësisë dhe transparencës, ishte provimi pranues për Fakultetin e Psikologjisë në vitin 2002.

Fakulteti i Psikologjisë si një fakultet i ri, i themeluar pas lufte, me një program të ri dhe qëndrim tjetër ndaj metodologjisë së studimeve, ishte bërë një destinacion shumë atraktiv për maturantët konkurrentë për studime në Universitet. Prandaj, në konkursin e sivjemë, për një vend konkurronin 10 maturantë.

Provimi pranues u mbajt më datën 11 korrik dhe u rezultatet u shpallën në afatin e caktuar.

Pas provimit, për shkak të ankesave të shumta të studentëve, Bordi i Universitetit kërkoi që të bëhej vlerësimi i ecurisë së punës së provimit pranues. Kështu u krijua një komision, i cili mori përsipër ta analizonte punën e bërë. Pas analizës së

⁴⁵ “Current Condition in the University of Prishtina”, a study of Index Kosova in 2001.

⁴⁶ “Health Financing Kosovo”, prezentim i George Boltonit, më 6 korrik 2002, në takimin e Grupit të Përhershëm Teknik Punues të ECMI në Prishtinë.

kryer u identifikuan shumë parregullsi, të cilat komisioni ia raportoi Bordit të Universitetit. Këto ishin disa nga parregullsitë⁴⁷: komisioni i provimit pranues, fillimisht kishte 5 anëtarë, por në ditën e provimit kishte mbetur me dy anëtarë, si dhe anëtarin e tretë të kooptuar për kontrollimin e testeve. Parregullsia e dytë ishte se provimi, i cili është dashur të fillonte në orën 9 (më 11 korrik 2002) nuk filloi deri në orën 13:30. Testi ka pasur lëshime teknike (psh. prej 5 përgjigjeve të mundshme, një ka qenë e saktë dhe precize, ndërsa ka pasur disa përgjigje të sakta, por jo precize, derisa udhëzimi u është dhënë gojarisht studentëve që të rrethojnë vetëm përgjigjen më të saktë). Mirëpo, këtu komisioni ka konstatuar parregullsinë e tretë, sepse udhëzimi është dhënë nga i njëjti person në një numër të madh klasësh, prandaj edhe nuk ka qenë uniform për të gjithë studentët. Çështja e ardhshme për komisionin ka qenë vlerësimi i eseve. Edhe pse ishte paraparë që pikët maksimale për ese të jenë 8, ka pasur raste, kur eseja, e cila është konsideruar e mirë është vlerësuar me 10 pikë. Kjo, sipas komisionit, ka qenë e parregullt. Po ashtu, një parregullsi tjetër lidhur me vlerësimin e eseve ka qenë se esetë e shkruara në gjuhën angleze janë vlerësuar në disa raste me më shumë pikë. Vërejtja e tretë në lidhje me esetë ka qenë se çdo ese është vlerësuar individualisht e jo në mënyrë ekipore, duke i lënë kështu hapësirë shumë të madhe subjektivitetit gjatë vlerësimit. Ka pasur edhe parregullsi të tilla, kur kandidatët kanë rumbullakësuar disa përgjigje për një pyetje. Studentëve nuk u është bërë e qartë numri i pikëve që fitohen nga pjesët e ndryshme të testit.

Komisioni për vlerësimin e ecurisë së punës këtë raport ia dorëzoi Bordit të Universitetit. Me këtë rast Bordi ka pasur

dy mundësi: 1 të shqyrtohen të gjitha parregullsitë individualisht; apo 2, të anulohet plotësisht provimi pranues. Bordi vendosi për anulimin e provimit duke i shkaktuar me këtë rast padrejtësi personave të pranuar në provimin e parë dhe në këtë mënyrë duke shkaktuar konfuzion në opinion. Edhe pse do të mund të thuhej se në provimin e dytë të gjithë do të paraqiteshin përsëri të barabartë, sigurisht se personat e pranuar gjatë herës së parë kanë qenë në një disavantazh të madh, sepse kanë pasur presion që ta ruajnë vendin e fituar më parë, derisa të tjerët do të kishin më pak për të humbur.

Provimi u përsërit, por tashti rezultatet ndryshonin shumë karshi rezultateve të para. Dyzet e tetë persona që e kishin kaluar testin herën e parë, tash nuk gjendeshin në listën e të pranuarve, e kjo ishte gjysma e të pranuarve. Kjo sigurisht tregonte për një padrejtësi ndaj këtyre individëve, gjë që shkaktoi revoltë të madhe ndër ta. Ky grup i kandidatëve u bë mjaft i zëshëm për mbrojtjen e të drejtave të tyre, duke ushtruar presion mbi Fakultetin dhe Rektoratin që ta dëgjojnë rastin e tyre. Ata e arritën këtë dhe kështu u formua një komision ad-hoc nga rektorati për ta shqyrtuar rastin. Pas shqyrtimit komisioni e pa të udhës që ta zgjerojë listën dhe të gjithë personat që ishin në listën e të pranuarve herën e parë (përveç 6 rasteve, 4 që ishte vlerësuar se nuk kishin plotësuar kushtet për të qenë as në listën e parë si dhe 2 që nuk ishin paraqitur në provimin e dytë), të pranoheshin krahas personave të pranuar gjatë provimit të dytë.

Me këtë vendim u siguroa, sadopak, drejtësi për të gjithë, mirëpo ky vendim përsëri tani anashkaloi vendimin paraprak të Bordit të Universitetit mbi anulimin e plotë të provimit të parë dhe në këtë mënyrë konfuzioni mbi procesin mbeti i pranishëm.

Ky rast tani është mbyllur dhe viti akademik ka filluar me sukses, mirëpo

⁴⁷ Informatat mbi parregullsitë në provimin pranues të raportuara nga komisioni për vlerësimin e ecurisë së punës janë marrë nga prof. Nait Vernezi, anëtar i këtij komisioni.

rasti na tregon për mungesën e standardeve në nivel të universitetit. Po ashtu, tregon se vendimet si për përpilimin e testeve, metodologjinë e përdorur e kështu me radhë, merren në bazë ad-hoc, duke u mbështetur në përvojat e mëhershme, të cilat nuk do të thotë të kenë qenë të suksesshme. Njëherësh, kjo tregon mungesën e koordinimit dhe të uniformitetit në Universitetin e Prishtinës përsa u përket provimeve pranuese.

Viktima dhe humbës në gjithë këtë punë janë, pikësisht, studentët, pastaj reputacioni i universitetit si institucion më i lartë arsimor dhe si pasojë e kësaj edhe niveli i rezultateve që dalin nga puna e universitetit.

Nevoja për ndërrimin e një situate të tillë është më se e qartë. Kjo do të ndikonte në seleksionimin më të drejtë të kandidatëve që për pasojë do të kishte shtimin e kualitetit të punës, rezultatet më të mira si dhe kthimin e reputacionit të mirë të universitetit në Kosovë dhe ndërkombëtarisht.

Do të ishte mirë po qe se në nivel të rektoratit do të krijohesh një trup punues që do të merrej ekskluzivisht me çështjen e provimeve pranuese. Ky trup do të duhej t'i studionte të gjitha sistemet e mundshme të provimeve pranuese, si dhe arsyeshmërinë dhe përshtatshmërinë e tyre me rrethanat në Kosovë. Një trup i tillë do të duhej të kishte përkrahje të gjerë si nga universitetit ashtu edhe nga qeveria.

Tash për tash, ekzistojnë disa nisma për krijimin e një grupi të tillë. Ndër to është edhe nisma e Qendrës Kosovare për Arsim (KEC)⁴⁸ në bashkëpunim me mësimdhënës universitarë si dhe disa përfaqësues nga Ministria. Po ashtu, grupin janë duke e ndihmuar edhe disa ligjërues të jashtëm të Universitetit të Prishtinës, të cilët janë duke u përcjellë përvojat nga vendet e tyre.

Përfaqësues nga rektorati nuk e kanë parë të udhës t'i bashkohen ende kësaj nisme.

Sido që të jetë, një grup i tillë do të duhej të merrte në konsideratë shumë faktorë të ndryshëm si dhe do të duhej të tentonte t'i fuste disa vlera të reja në procesin e pranimit të studentëve për studime në Universitetin e Prishtinës.

Një nga zgjidhjet e mundshme që ky trup punues do të mund t'i merrte parasysh, është edhe që procesi i pranimit të menaxhohet nga një grup i pavarur, një lloj organizate joqeveritare, e cila do të kishte përgjegjësinë për të gjithë procesin. Kjo organizatë do të punonte në mënyrë plotësisht transparente dhe do të përgjigjej penalisht për çfarëdo keqpërdorimi.

Sa i përket vetë procesit të pranimit, pra mënyrës së testimit të studentëve potencialë, ekzistojnë disa metoda të cilat janë duke u diskutuar.

Metoda e parë është **Testi i Aftësive**, i cili është një test i aftësive të përgjithshme intelektuale për të studiuar në universitet. Një test i tillë do të vlente për të gjithë konkurrentët dhe nuk do të ishte specifik për lëndë të caktuara. Për drejtimet me nevoja më specifike, si artet, testi do të mund të adoptohej për të përfshirë këto kërkesa specifike. Përparësitë e kësaj metode janë se testi është i njëjtë për të gjithë dhe provimi do të mund të mbahej në të njëjtën kohë për të gjithë. Testi do të mund të përsëritej disa herë nga studenti. Kualiteti i tij do të ishte i garantuar, sepse do të ishte i testuar që më herët e jo siç është gjendja tani, kur testet përpilohen në mënyrë ad-hoc nga fakultetet pa kontroll të standardizuar kualiteti. Përparësia tjetër është se vlerëson aftësinë intelektuale për të studiuar në universitet. Të metat e një metode të tillë do të ishin se studentët nuk testohen për lëndën që dëshirojnë ta studiojnë dhe në këtë mënyrë do të ekzistonte mundësia që studentët e shkëlqyeshëm vetëm në një fushë të caktuar të mos e kalojnë testin, sepse janë shumë të specializuar vetëm në atë fushë.

⁴⁸ "Discussion paper on entrance exams at University of Prishtina", by Per Sonnerby, 9 September 2002.

Metoda e dytë e përfolur është **pranimi në universitet në bazë të notave nga shkolla e mesme**, duke marrë parasysh mesataren e të gjitha lëndëve apo edhe duke u fokusuar në suksesin e disa lëndëve specifike. Kjo metodë do të ishte shumë joefektive në Kosovë për shkak të mënyrave dhe standardeve të ndryshme të vlerësimit në shkollat e ndryshme të mesme nëpër Kosovë. Prandaj kjo mënyrë do të favorizonte apo disfavorizonte kandidatët në mënyrë të padrejtë.

Një metodë më radikale, por më e drejtë dhe humane, e cila është propozuar, është **regjistrimi i të gjithë maturantëve** të interesuar për të vazhduar studimet në universitet. Të gjithë ata do të regjistroheshin në vitin e parë universitar që do t'i përfshinte të gjitha fushat e studimeve dhe studentët do të mund të zgjedhnin lëndët që dëshirojnë t'i përcjellin për një vit. Në fund të vitit, duke u bazuar në rezultatet që kanë treguar, do të bëhej edhe kualifikimi dhe regjistrimi i studentëve më të aftë në fushat e ndryshme. Në një formë kjo do të ishte sikur një provim pranues që do të zgjaste një vit. Në këtë mënyrë do t'u jepej mundësia studentëve që gjatë vitit të vendosin ngadalë për fushën e studimeve të tyre. Po ashtu, do të ishte një kualifikim më i thellë bazuar në rezultate më objektive të punës së tyre. Njëherësh, edhe studentët, të cilët nuk do të arrinin të kualifikoheshin, së paku do të kenë një vit studim universitar, gjë që do të ndikonte në përgatitjen e tyre për punë. Mirëpo, kjo metodë është shumë e shtrenjtë dhe nuk ekziston hapësirë e mjaftueshme në infrastrukturën e Universitetit për t'i përfshirë të gjithë këta studentë.

Edhe një metodë tjetër është **kombinimi i metodave** të paraqitura më lart. Në këtë mënyrë do të kombinoheshin pikët e fituara nga sukcesi në shkollën e mesme, nga rezultatet e testit të aftësive dhe testit specifik për tema të caktuara. Në këtë mënyrë do t'u jepej mundësia të gjitha kategorive të kandidatëve - ata që kanë sukses të mirë nga shkolla e mesme,

kandidatët e specializuar si dhe ata me aftësi të larta që të kenë mundësi të mira për t'u pranuar. Mirëpo, me këtë metodë do të mund të vazhdonim të ballafaqoheshim me probleme të ngjashme me ato të sotmet.

Është me rëndësi që të krijohet një trup i pavarur në nivel të universitetit, i cili do të kishte për detyrë që t'i studionte metodat e mundshme dhe pastaj t'i implementonte këto në praktikë. Ky trup do të ishte i përhershëm dhe personat e angazhuar aty do të duhej të punonin me orar të plotë vetëm në këtë lëmi. Pa marrë parasysh metodën që do të zgjedhej si më e mira, detyra e këtij trupi do të ishte që vazhdimisht të studiojë mundësitë e përmirësimit të mëtejme të metodës së pranimit të studentëve, ashtu që ta bëjë atë sa më të drejtë.

Vetë provimi pranues do të duhej të udhëhiqej ose nga ky trup apo ndonjë trup tjetër që do të ishte i pavarur që do të merrte përsipër vetë procesin e mbajtjes së provimit dhe të kontrollimit të tij.

Në të njëjtën kohë duhet të krijohet edhe një Shërbim Këshillues për kandidatët potencialë, ashtu që ata të kenë një orientim më të mirë sa i përket lëmit të studimeve, ashtu edhe që t'i informojë ata mbi procesin e pranimit.

Një rekomandim i qartë që del nga gjendja aktuale dhe që do të ndikonte që procesi i pranimit të jetë më i drejtë e po ashtu që të plotësohen nevojat e shoqërisë kosovare, është që të shtohet numri i studentëve që mund të pranohen për të studiuar në Universitet.

VII. FINANCAT

Gjendja financiare në UP është tepër e rëndë. Pozita materiale e mësimdhënësve është më tepër se e mjerë. Pagat e tyre janë prej 120 – 270 €. Kjo situatë e rënduar financiare ka bërë që mësimdhënësit të

janë shumë pak të përqëndruar në punën me studentë. Shumë prej tyre, për këtë shkak, punën në Universitet e kanë të rendit të tretë e të katërt, sepse paga që e marrin aty, nuk ua siguron ekzistencën.

Shumica e tyre përpiqen ta sigurojnë ekzistencën duke punuar jashtë universitetit, ndërsa punën në universitet e kanë më shumë çështje prestigji shoqëror. Me stimulim të tillë financiar, ata nuk punojnë seriozisht as për ngritjen e tyre profesionale që vetvetiu është e hendikepuar për shkak të kushteve të rënda, nëpër të cilat ata punuan gjatë gati 10 vjetëve për sa ishin të dëbuar nga objektet e universitetit. Kjo situatë materiale e arsimitarëve nuk po e dëmton UP-në vetëm nëpërmjet mospunës së mjaftueshme të mësimdhënësve aktualë. Një situatë e tillë nuk krijon kushte për të ofruar kuadro të reja e të shkolluara në universitetet e jashtme, por edhe të vetë të rinjve ambiciozë që dalin nga UP-ja. Kështu po dëmtohet shumë rëndë edhe procesi i kalimit të UP-së nga gjenerata më e vjetër në gjeneratën e re.

Andaj me të drejtë në këtë rrafsh shtrohen shumë pyetje që duan trajtim dhe zgjidhje. Komercializimi i shërbimeve të Universitetit dhe participimi nga studentët është një çështje e veçantë që kërkon analiza të gjerësishme. Nëse ndiqen trendet botërore në këtë aspekt, atëherë Universiteti i Prishtinës do të duhej t'i aplikonte menjëherë studimet me pagesë. Studimet kualitative janë të shtrenjta dhe nuk ka mundësi që ato të vazhdojnë të ofrohen falas për një kohë të gjatë. Kur kërkohet ruajtja e kualitetit të studimeve apo edhe përmirësimi i tyre, participimi me pagesë nga studentët është i domosdoshëm dhe do të shërbente si ndihmë në këtë kuadër. Studimet që janë falas nuk e shtyjnë studentin që ta japë maksimumin për të arritur rezultate të mira. Kur paguhet shërbimi, atëherë studenti e ndien vetën të obliguar që të punojë dhe të arrijë diçka, sepse përndryshe shpenzimi i tij do të shkojë kot. Studimet pa pagesë nuk stimulojnë punë

për sukses, ndërsa studimet me pagesë do ta stimulojnë studentin dhe ekziston mundësia që do ta ngrisin kualitetin e studentëve të diplomuar. Ndërkaq, buxheti i Universitetit të Prishtinës do të përfitonte të hyra vetanake të rregullta që do të ndihmonin stabilitetin e gjendjes financiare të tij. Aktualisht në UP studentët nuk paguajnë për shkollimin e tyre. Mësimdhënësit janë të mendimit që studimet të bëhen me pagesë e jo të aplikohet vetëm një shumë e vogël participimi si deri tash⁴⁹.

Mirëpo, në rastin e Kosovës nuk mund të aplikohen menjëherë të gjitha standardet që aplikohen në vendet e Përendimit, duke pasur parasysh edhe gjendjen e rënduar sociale të banorëve të Kosovës. Prandaj edhe rreth kësaj çështjeje do të duhej pasur kujdes se si zgjidhet. Nuk ka dyshim se në rast të aplikimit të participimit do të ketë studentë që nuk do të ishin në gjendje t'i përballonin çmimet e shërbimeve të universitetit. Nga të dhënat e hulumtimit me studentë del se 70% e studentëve e kundërshtojnë plotësisht idenë që studentët me notë mesatare më të vogël se 7,5 të paguajnë rreth 200 euro për regjistrimin e semestrit. Në anën tjetër, mendimi i mësimdhënësve është plotësisht i kundërt me atë të studentëve. Ata janë të mendimit që të aplikohen shuma të mëdha për regjistrimin e vitit, me disa sugjerime edhe prej 1.000 eurosh, pasi që sipas tyre studenti ka të drejtë të kërkojë kundërvlerën e atyre parave në kualitetin e mësimin që i ofrohet⁵⁰. Mirëpo, këtu mund të ndihmojnë palët e treta përmes ofrimit të bursave për studentët e shkëlqyeshëm, të cilët nuk kanë mundësi financiare për t'i paguar studimet.

Po ashtu, në të njëjtën temë, Universiteti i Prishtinës mund të bëjë marrëveshje

⁴⁹ Hulumtimi kualitativ mësimdhënës të UP, zhvilluar në Prishtinë nga Index Kosova, më 5 nëntor 2002.

⁵⁰ Hulumtimi kuantitativ me studentët e UP, zhvilluar nga Index Kosova më 20-23 tetor 2002 në Prishtinë.

eventuale me bankat vendore dhe ato ndërkombëtare. Përmes marrëveshjeve, Universiteti do t'ua mundësonte studentëve që të marrin kredi për mbulimin e shpenzimeve të pagesës së studimeve. Zakonisht kreditë e tilla janë me kushte të volitshme për studentin, me një kamatë modeste dhe kthimi i kredisë fillon jo më pak se 6 muaj pas diplomimit të studentit. Obligimi ndaj kredisë për këta studentë do të ishte edhe një formë tjetër e stimulimit për të treguar sukses në studime dhe për të siguruar një vend të punës pas diplomimit⁵¹.

VIII. TREGU I PUNËS

Në situatën në të cilën gjendet sot Kosova, mundësitë për punësim pas mbarimit të studimeve janë shumë të vogla. Normalisht, kjo ka të bëjë edhe me tregun e punës në Kosovë që është në gjendje të mjerueshme e që lidhet drejtpërdrejt me gjendjen ekonomike në të cilën po kalon Kosova. Në situatën e tanishme ky treg nuk ka mundësi t'i punësojë të gjithë studentët të cilët diplomojnë në Universitetin e Prishtinës. Ekonomia e Kosovës është në një stad shumë të ulët të zhvillimit të vet, andaj edhe shumë profile që dikur ishin shumë të kërkuara sot janë gati të panevojshme.

Në të kaluarën, para viteve 90, Kosova kishte arritur që të ngre në këmbë një industri të veten të rëndë dhe të lehtë, andaj, edhe profilet e teknologëve, metalurgëve, inxhinierëve të elektros, makinerisë etj. ishin shumë të kërkuara dhe të nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së Kosovës. Mirëpo, që

atëherë kanë ndodhur shumë ngjarje që e kanë shkatërruar gati tërësisht ekonominë e Kosovës dhe, njëkohësisht, arsimin e Kosovës e kanë vënë në buzë të ekzistencës (përzënia e punëtorëve shqiptarë nga vendet e punës pas vitit 1990 dhe lufta e viteve 1998/1999). Kështu, sot, kur ekonomia e Kosovës kryesisht është e përqëndruar në tregti dhe buxheti i Kosovës varet kryesisht nga vjelja e doganave, këto profile të arsimit që dikur ishin më shumë perspektivë, tani nuk ofrojnë shumë mundësi. Kjo natyrisht ka bërë që intersimi i të rinjve për këto profesione nga viti në vit të zvogëlohet⁵².

Sot janë shumë të kërkuara ato fakultete që të sigurojnë më shpejt dhe më lehtë punësim, si fakultetet e gjuhëve të huaja, Fakulteti i Drejtësisë, i Ekonomisë si dhe Fakulteti i Shkencave Politike. Për këto fakultete interesimi është i madh, sepse edhe kërkesa për kuadro të kualifikuara që do të punonin në administratën vendore, që është në krijim, po rritet. Është interesant të theksohet se një lloj euforie që më parë ishte përqëndruar për regjistrim në Fakultetin e Mjekësisë ka rënë, sigurisht edhe për shkak të pagave të ulta të mjekëve që punojnë në institucionet shëndetësore publike.

Një situatë e tillë ka bërë që numri i studentëve të diplomuar, në lëmi të ndryshme e që mbesin të papunë për një kohë të gjatë apo që gjejnë një punë joadekuate për profesionin e tyre, të rritet në vazhdimësi. Rrjedhimisht, punësimi i atyre që e kanë mbaruar universitetin, por edhe rritja e cilësisë së arsimit në universitet do të rritet në proporcion me zhvillimin ekonomik të Kosovës. Sa më shumë që të zhvillohet ekonomia e

⁵¹ Një shembull konkret i suksesshëm i studimeve me pagesë është kolexhi turko-amerikan në të cilin studentët duhet të paguajnë shuma të mëdha në fillim, mirëpo kjo shkollë i siguron literaturë, internet, rend e rregull, dhe nëse studenti tregohet i suksesshëm, atij i zbritet pagesa për vitin e ardhshëm.

⁵² Në vitin shkollor 1999/2000 në Universitetin e Prishtinës kanë diplomuar 1.617 studentë. Nëse ky numër krahasohet me numrin e vendeve të lira të punës, prej të cilit një numër i madh nuk kërkon kualifikim universitar, del se mundësia për punësim e këtyre individëve është shumë e ulët. – D. Pupovci, H. Hyseni, J. Salihaj, “Arsimi në Kosovë”, 2000/2001, botimi shqip, Prishtinë, dhjetor 2001.

Kosovës, aq më shumë do të paraqitet nevoja për konkurrencë në dije në mes të atyre që i mbarojnë studimet. Zhvillimi ekonomik i Kosovës del një faktor i rëndësishëm i zhvillimit të tregut të punës dhe i krijimit të mundësive më të mëdha për punësim pas mbarimit të studimeve.

Njëkohësisht me zhvillimin e ekonomisë, edhe profilizimi në Universitet mund të ndihmojë për plotësimin e kërkesave të tregut për punëtorë profesionistë në lëmenj të caktuar specifikë. P.sh. brenda vitit, në degën e Gjuhës Shqipë regjistrohen 120 studentë, ndërsa numri i njerëzve që janë të diplomuar dhe të papunë në këtë profil është shumë i madh. Ndërkaq, mungesa e kudrove të profilizuara, siç janë gazetarët, përkthyesit profesionistë, etj. është shumë e madhe. Normalisht, nëse shumica e studentëve kanë të njëjtin profil të përgjithshëm të studimeve në universitet, atëherë asnjë prej tyre nuk do të ketë avantazhe konkurruese në ndonjë lëmi specifike ndaj kandidatëve të tjerë konkurrues.

Universiteti i Prishtinës ka bërë pak në ofrimin e asistencës ndaj studentëve për punësim pas diplomimit. Në UP nuk ekziston një qendër e mirëfilltë për planifikim dhe zhvillim të karrierës që do t'u mundësonte studentëve të marrin udhëzime praktike se si të përgatiten për punësim ose specializim të caktuar pas diplomimit. Qendra të tilla janë të praktikuara në shumë univerzitate botërore dhe janë pjesë e planprogramit mësimor. Përmes këtyre qendrave, universiteti do të kishte mundësi t'u ofronte studentëve këshilla profesionale për hulumtimin e vendeve të lira të punës, asistencë teknike për përgatitjen e CV-ve dhe letrave prezentuese, udhëzime praktike për intervistim për punësim, si dhe metoda praktike për negociata për kushte të kontratës së punës.

Po ashtu, Universiteti i Prishtinës duhet të bëjë më shumë për ofrimin punës praktike për studentë nëpër ndërmarrje private apo publike. Angazhimi i studentëve si

praktikantë nëpër ndërmarrje ekzistuese u mundëson studentëve që të krijojnë kontakte me këto ndërmarrje, të cilat janë punëdhënës të mundshëm për studentët e diplomuar. Kjo mund të arrihet përmes marrëveshjeve që Universiteti mund të bëjë me punëdhënës të mundshëm. Këto marrëveshje mund të sjellin edhe të ardhura për Universitetin, siç ndodh në shumë universitete perëndimore. Një shembull konkret se si mund të bëhet kjo është kur një punëdhënës kërkon një praktikant në një fushë të caktuar, Universiteti mund të angazhohet për ta gjetur këtë praktikant nga radhët e studentëve. Ky do të ishte një shërbim për të cilin punëdhënësi mund t'ia paguajë një shumë fikse Universitetit, derisa studenti të punësohet si praktikant pa pagesë. Mirëpo, punësimi është me afat të caktuar dhe me një praktikë të tillë studenti jo vetëm që i zgjeron aftësitë dhe përvojën e tij, por edhe mund të përdorë këtë praktikë për të fituar kredi drejt diplomimit në Universitet.

Studentët, të cilët marrin diplomë të Universiteti i Prishtinës, momentalisht, nuk janë të gatshëm t'i përmbushin kërkesat e tregut as nga aspekti i përvojës së caktuar të punës në lëminë e studiuar. Në disa shtete të Evropës Qendrore dhe Jugore, universitetet janë iniciatore që studentëve t'u mundësojnë kryerjen e punës praktike gjatë studimeve për afat të caktuar, prej 6 muaj deri në 2 vjet. Këta studentë pastaj janë të gatshëm të punësohen menjëherë pa pasur nevojë që pas diplomimit të vazhdojnë si praktikantë për një periudhë 1vjeçare.

Në të ardhmen mund të mendohet se, gradualisht, Universiteti i Prishtinës ta zvogëlojë numrin e studentëve në disa profile, për të cilat nuk ekziston nevojë e madhe në tregun e punës në Kosovë sot. Në të njëjtën kohë duhet të ketë një profilizim më të mirë të drejtimeve studimore, ashtu që të plotësohen nevojat deficitare ekzistuese në tregun e punës.

Në reformën e Universitetit të Prishtinës është paraparë që për çdo profesor të ketë jo më shumë se 20 studentë. Një relacion i tillë profesor – student lejon interaksion më të madh midis tyre duke e ngritur kështu kualitetin e studimeve. Nëse numri i studentëve për profesor është i madh, atëherë kjo e kufizon mundësinë e profesorit për t’iu përgjigjur kërkesave individuale të studentëve. Numri më i vogël i studentëve do ta largonte Universitetin e Prishtinës nga rangu i universiteteve masovike, ku studentit nuk i ofrohet vëmendje dhe përkujdesje e mjaftueshme. Koncepti i arsimit masiv është koncept i periudhës së socializimit dhe si i tillë është i tejkaluar. Ekonomia e tregut nuk mund ta absorbojë prodhimin masiv të kuadrove, por edhe kuadrot nuk mund të formohen në nivel të duhur profesional në një atmosferë studimi, ku mungon raporti interaktiv mësimdhënës – student, për shkak të masovitetit të faktorit student.

IX. ARSIMI PRIVAT NË KOSOVË

Në vitet kur është krijuar Universiteti i Prishtinës në Kosovë, ka sunduar sistemi monist, brenda të cilit nuk është lejuar ekzistimi i çfarëdo institucioni arsimor privat. Së këndejmi, historiku i arsimit privat në Kosovë është i shkurtër.

Ligji i pamiruar ende mbi Arsimin e Lartë të Kosovës i parasheh institucionet private të arsimit të lartë dhe ka krijuar gjithë mbështetjen juridike në këtë kuadër. *“Një bartës privat i arsimit të lartë mund të krijohet nga një person privat, nga një organizatë apo fondacion privat, me vendqëndrim në Kosovë apo që ka një zyrë të regjistruar në Kosovë”*.⁵³

Ndonëse nuk është miratuar ende ky ligj, në Kosovë tashmë janë duke funksionuar disa institucione private arsimore: Shkolla e Lartë e Gazetarisë “Faik Konica”, Qendra e Komunikacionit për Arsim dhe Studim të Lartë “Tempulli”, Shkolla e Lartë e Artit e udhëhequr nga Enver Petrovci etj.

Këto institucione janë një alternativë Universitetit të Prishtinës. Ato kanë plotësuar një boshllëk që ka ekzistuar në disa profile të caktuara, siç janë gazetaria, trafiku etj. Konkurrenca që mund ta shkaktojë institucionet private të arsimit, mund ta avansojë nivelin e mësimin edhe brenda UP-së. Arsimi privat është duke i thyer edhe disa mentalitete të ngulitura në shoqërinë e Kosovës, andaj edhe vërehet një lloj rezistence ndaj këtij lloji të arsimit, duke u nisur që nga Ministria e deri tek UP-ja dhe fakultetet e saj. Kjo lloj rezistence vjen nga logjika e krijuar se arsimit duhet të jetë vetëm falas dhe publik. Natyrisht, një luftë intereseash do të ekzistojë gjithnjë ndërmjet institucioneve publike dhe atyre private të arsimit. Profesori Pango nga Universiteti i Tiranës, moskujdesin e shtetit dhe të organeve të Universitetit në Tiranë ndaj situatës materiale të profesorëve e sheh në prizmin e përpjekjeve që individë të caktuar me ndikim në këto organe e bëjnë për të marrë kuadrin arsimor nga universitetet publike në ato private.⁵⁴

Shkolla e parë private në Kosovë është Shkolla e Lartë e Gazetarisë “Faik Konica”. Mungesa e degës së gazetarisë në UP dhe shfaqja e nevojës për gazetarë pas lindjes së shumë medimeve të reja ka nxitur hapjen e kësaj shkolle nga gazetari i vjetër dhe shkrimtari Ramiz Kelmendi. Kjo shkollë, e cila sot ka rreth pesëmbëdhjetë mësimdhënës të kualifikimeve dhe profileve të ndryshme, ka dhënë një pjesë të gazetarëve të rinj të kualifikuar në mediumet kosovare.

⁵³ Ligji mbi Arsimin e Lartë, Kapitulli 6, Neni 22.1, fq.36

⁵⁴ Prof.Dr.Ylli Pango, Disa arritje në shkatërrimin e Universiteteve, Koha Jonë, 7.11.2002

Mungesën e një profili tjetër në UP e ka shfrytëzuar edhe Qendra e Komunikacionit për Arsim dhe Studim të Lartë, “Tempulli”, e udhëhequr nga Muhamet Krasniqi. Kosova ka mungesë të madhe të kuadrove nga komunikacioni dhe kjo shkollë është konceptuar në funksion të mbushjes së këtij boshëllëku në këtë lëmi. Kjo shkollë është e pajisur në një nivel të lakmueshëm me pajisje arsimore dhe me kuadër arsimor. Studimet në këtë shkollë janë të rregullta dhe zgjasin tre vjet. Studimet janë të ndara në tri drejtime: komunikacioni rrugor, komunikacioni hekurudhor dhe posta e telekomunikacioni. Deri më tani është duke ndjekur mësimet gjenerata e dytë. Dy gjenerata kanë nga 90 studentë dhe standardi i mësimit sipas Krasniqit konsiderohet të jetë “më i lartë se në Universitetin e Prishtinës”. Studimet paguhen nga studentët. Kuadrot janë nga UP-ja, ekspertë të tjerë nga Kosova dhe ndonjëherë edhe ekspertë ndërkombëtarë. Ky institucion arsimor ka një marrëveshje zyrtare për bashkëpunim (memorandum) me Universitetin e Sarajevës - Fakulteti i Komunikacionit. Në këtë shkollë studiojnë, po ashtu, edhe kuadrot e hekurudhave të Kosovës dhe llogaritet se nga viti i ardhshëm do të ketë edhe studentë nga Shqipëria dhe IRJM. Kjo shkollë deri tash ka qenë e akredituar nga ish-Departamenti i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe tani është në pritje të licencimit nga Minsitria aktuale. Në ligj, në nenin 22, paragrafin 4, përshkruhet një ndër kushtet kryesore për licencim: *“Një kusht për marrjen e licencës nga një institucion privat i arsimit të lartë është paraqitja pranë Ministrisë të një plan biznesi për bartësin, duke përfshirë një garanci nga ana e themeluesit të institucionit për qëndrueshmëri financiare për të paktën 3 vjet. Zbatimi i këtij plani, duke përfshirë këtë garanci, i paraqitet çdo vit ministrisë.”*⁵⁵ Ndonëse zyrtarët e qendrës pohojnë se i kanë plotësuar kushtet, duke përfshirë edhe paraqitjen e

planit të biznesit, leja nuk është dhënë ende. Kjo po zvarriset edhe për shkak të vakuimit ligjor. Krasniqi u ankua se nuk ka marrë asnjë ndihmë financiare nga ana e Ministrisë, ndonëse kuadrot që dalin nga kjo qendër arsimore janë të dobishme për shoqërinë dhe ekonominë e Kosovës.

Ministria dhe organet e tjera qeveritare do të duhej që me një trajtim pozitiv t’i inkurajojnë edhe financiarisht këto shkolla si dhe shkollat e tjera, ashtu siç e përcakton edhe ligji. Ligji e rregullon edhe këtë çështje përmes nenit 23, paragrafit 1: *“Bartësit e akredituar privatë të arsimit të lartë mund të marrin mjete financiare nga Ministria për mësimëdhënie dhe kërkime shkencore në interes të përgjithshëm”*.⁵⁶ Ndihma ndaj këtyre inistitucioneve të arsimit të lartë do të ishte ndihmë zhvillimit shoqëror të Kosovës, sepse nga këto institucione po krijohen kuadro që i mungojnë Kosovës. Gjithashtu, këto institucione do të jenë një hap i mirë drejt riorganizimit të sistemit tonë arsimor dhe përshtatjes së standardeve të këtij sistemi me sistemet e përparuara të Perëndimit (jo vetëm me ligj, por edhe praktikisht e në mënyrë përmbajtësore).

Një mundësi tjetër është shembulli i shteteve të Perëndimit, ku biznesmenët privatë investojnë në shkollimin privat dhe në këtë mënyrë lirohen nga taksat apo përfitojnë ndonjë beneficion tjetër.

Sigurisht që për momentin konkurrenti kryesor i UP-së do të jetë Kolegji Amerikan që pritet të hapet vitin e ardhshëm, sipas standardeve më të larta arsimore. Konkurrenca në vendet e tjera është dëshmuar se ka funksionuar në favor të ngritjes së cilësisë së arsimit.

⁵⁵ Ligji mbi Arsimin e Lartë, Neni 22.4, fq.36

⁵⁶ Ligji mbi Arsimin e Lartë, Neni 23.1, fq.37

X. MINORITETET NË SHKOLLIMIN E LARTË NË KOSOVË

Kosova si një vend, në të cilin jetojnë edhe popuj të tjerë përveç shqiptarëve, që nga themelimi i Universitetit të Prishtinës ka pasur shkollim në tri gjuhë: shqip, serbisht, turisht. Gjatë historisë së ekzistencës së Universitetit, që nga vitet e shtatëdhjeta, Universiteti përpos mësimin në gjuhën shqipe për popullatën shumicë, ka pasur edhe mësimin në gjuhën serbo-kroate. Mësimi në gjuhën turke ka qenë i kufizuar në një katedër brenda Universitetit.

Një bashkekzistencë, e cila funksiononte sadopak, filloi të prishej pas demonstratave të vitit 1981, kur serbët filluan ta shohin Universitetin e Prishtinës, në fakt shkollimin e lartë të shqiptarëve, si një kërcënim për ta⁵⁷. Një qëndrim i tillë filloi të bëhej gjithnjë e më i dukshëm dhe presioni, atëherë, filloi të shtoej vazhdimisht mbi Universitetin. Kjo kulmoi në fillim të viteve të nëntëdhjeta, kur pas heqjes së dhunshme të autonomisë së Kosovës nga qeveria serbe, u vendos një sistem apartheidi, në të cilin viktimat e parë ishin pikërisht shkollimi i shqiptarëve. Atyre me këtë iu ndalua jo vetëm shkollimi sipëror, por, në fakt, shkollimi në përgjithësi, me ç'rast mësimdhënësit dhe nxënësit shqiptarë u dëbuan nga objektet e tyre shkollore. Në Universitet atëbotë u larguan pothuajse të gjithë mësimdhënësit shqiptarë dhe së fundi edhe u ndalua regjistrimi i studentëve për të vijuar studimet në gjuhën shqipe. Kjo bëri që shkollimi në gjuhën shqipe të kalonte në ilegalitet, kur edhe u organizua sistemi i tërë i shkollimit, të cilit shpesh i referohemi si "sistem paralel". Kjo formë e

suksesshme e rezistencës ndaj agresionit kundër arsimit të shqiptarëve është shumë e njohur edhe ndërkombëtarisht. Mirëpo, një gjë e tillë kishte edhe çmimin e vet. Mësimet zhvilloheshin në kushte shumë të vështira, duke përdorur bodrume dhe dhoma shtëpish private për të mbajtur orët. Suksesi dhe diplomat e lëshuara nga ky sistem nuk ishin të pranuar nga pushteti i atëhershëm, prandaj ishte edhe tepër vështirë, thuajse e pamundur, të punësoheshe me një diplomë të tillë. Gjërat i rëndonte edhe statusi i Kosovës në atë kohë, ashtu që diplomat e Kosovës njiheshin vetëm në disa vende të huaja.

Megjithë përpjekjet e shumta gjatë viteve nëntëdhjetë, ky sistem mbeti i tillë deri në vitin 1999, kur u vendos administrata ndërkombëtare në Kosovë. Ndërkohë, serbët në Kosovë në arsim gëzonin një status mbi të gjithë, sikurse edhe në çdo sferë tjetër të jetës. Ata i kishin kushtet e privileguara, mund të thuhet edhe mbi standarde. Ata gjatë kësaj kohe ishin duke i shfrytëzuar të gjitha hapësirat dhe pajisjet e Universitetit të Prishtinës, të cilat deri në fillim të viteve nëntëdhjetë ishin shfrytëzuar bashkërisht me shqiptarët (të cilët edhe përbënin në atë kohë shumicën e studentëve dhe të mësimdhënësve në Universitet). Kjo pozitë e tyre dhe përkrahja e pamasë që kishin nga Beogradi i kishte vendosur ata pothuajse në pozitën e perandorit. Me mundësinë e studimit të çfarëdo dege, pothuajse pa kurrëfarë standardesh, si dhe me punësim të sigurt pas përfundimit të studimeve, serbëve në Kosovë kjo u jepte kushte dhe mundësi të mëdha në shpinë të popullatës shumicë, shqiptarëve. Pjesa më e madhe e studentëve në Universitet ishin serbë që vinin nga vise jashtë Kosovës (Serbi dhe Mal i Zi)⁵⁸.

Pas përfundimit të luftës, në vitin 1999, shqiptarët u kthyen jo vetëm nëpër shtëpitë e tyre në Kosovë, por edhe në vendet e tyre

⁵⁷ Vujadin Milanović, "Univerzitet u Prištini u mreži velikoalbanske strategije" (Universiteti i Prishtinës në rrjetin e strategjisë shqiptaromadhe), botuar nga "INP Knjizevne novine", Beograd dhe "NIRO JEDINSTVO", Prishtinë, 1990; f. 23-25.

⁵⁸ "The State of Education in Kosovo after the Case-fire in June 1999", by Elmar Pichl and Carolin Leutloff.

të punës, nëpër shkolla dhe në Universitet. Për shkak të tensioneve të larta ndëretnike të krijuara si pasojë e apartheidit dhjetëvjeçar dhe luftës së posapërfunduar, një numër i serbëve u largua nga Kosova. Në këtë kohë serbët, po ashtu, u tërhoqën nga Universiteti i Prishtinës. Duke tentuar që të mbajnë një vazhdimësi të Universitetit të privilegjuar, të cilin e kishin gëzuar gjatë të nëntëdhjetave, këta hapën fakultetet e tyre nëpër disa qytete të Serbisë si vazhdimësi e Universitetit të Prishtinës, gjë që ishte e përkrahur nga qeveria serbe në Beograd.

Ndërkohë, menjëherë, qysh në verën e vitit 1999 kishte filluar viti akademik në gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës, tani në lokalet e veta, si kompenzim për semestrin që ishte humbur pas eskalimit të luftës në fillim të vitit 1999. Mësimdhënësit dhe studentët u kthyen në lokalet që i takonin Universitetit, por të cilat u ishin mohuar për aq gjatë dhe filluan ta rindërtojnë sistemin arsimor.

Tani jemi duke hyrë në vitin e katërt akademik prej mbarimit të luftës dhe procesi mësimor në gjuhën shqipe është në përparim të vazhdueshëm. Po ashtu, janë hapur edhe disa katedra në gjuhë të tjera, si në gjuhën turke dhe boshnjake. Mirëpo, për shkaqe sigurie mësimdhënësit dhe studentët serbë nuk janë kthyer në lokalet e Universitetit të Prishtinës. Edhe pse ka pasur disa iniciativa si nga ana e ndërkombëtarëve, ashtu edhe nga vetë Universiteti i Prishtinës me propozime për kthimin e tyre, këto kanë mbetur vetëm si propozime për shkak të gjendjes së sigurisë. Në anën tjetër edhe vetë serbët në një mënyrë nuk kanë qenë edhe aq të interesuar të kthehen në Universitet, për shkak të qëllimit të tyre që të mbeten nën sistemin arsimor të Serbisë dhe të jenë të ndarë nga zhvillimet në Kosovë. Kjo u pa edhe nga emërimet e bëra nga pala serbe për Universitet⁵⁹.

Ndërkohë, serbët përsëri i kanë lëvizur katedrat e tyre, të cilat i konsiderojnë si vazhdimësi e Universitetit të Prishtinës nga vitet e nëntëdhjeta, nga qytetet në Serbi për në pjesën veriore të qytetit e ndarë të Mitrovicës. Kërkesa e tyre është që t'u njihet Universiteti i pavarur i Mitrovicës, i cili do të ishte ekskluzivisht për serbë dhe i cili do të punonte me planprograme dhe mbikqyrjen e Ministrisë së Arsimit të Serbisë. Sigurisht se kjo rrjedh edhe nga pozita e privilegjuar që këta kanë pasur gjatë viteve të nëntëdhjeta, pozitë kjo nga e cila sigurisht është vështirë të hiqet dorë.

Si duket, kjo ide për një universitet të ndarë serb, kishte përkrahje edhe nga disa ndërkombëtarë në Kosovë - në këtë rast duhet theksuar Mihajl Daksnerin, ish-bashkëkryesues i Departamentit të Arsimit dhe bashkërektor i Universitetit të Prishtinës. Kjo u manifestua edhe gjatë përpilimit të Ligjit mbi Arsim të Kosovës, në të cilin Daksneri ngulte këmbë që të figurojë emërtimi Universiteti i Mitrovicës. Mirëpo, një gjë e tillë nga parlamentarët shqiptarë u konsiderua si veprim që çon në drejtim të kundërt me zhvillimet e shkollimit të lartë në Kosovë, i cili synon të zhvillohet në frymën e Marrëveshjes së Bolonjës dhe të jetë kompatibil me sistemet e tjera në Evropë. Ligji mbi Arsimin, për këtë arsye edhe u modifikua në parlament dhe si i tillë u aporvua nga parlamenti. Mirëpo, si çdo ligj tjetër, para se të hyjë në fuqi, edhe ky duhet të firmoset nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Një gjë e tillë, tash për tash, duket larg, pasi

Fakultetit të Ekonomisë dhe Ministër Federativ i Shkencës në Qeverinë e Milosheviqit. Ai është ndër njerëzit që kanë qenë kryesisht përgjegjës për segregacionin në arsimin e lartë në Kosovë gjatë viteve të fundit. Si vazhdim i këtij qëndrimi, ai dhe kolegët e tij vazhdojnë ta shikojnë universitetin shqiptar – pa i përfillur rrethanat e ndryshuara politike – si një universitet privat dhe ende pretendojnë të jenë universiteti i vetëm zyrtar i Prishtinës” – “The State of Education in Kosovo after the Case-fire in June 1999”, by Elmar Pichl and Carolin Leutloff.

⁵⁹ “Në anën serbe, Beogradi e ka emëruar rektorin e ri (për Universitetin serb të Prishtinës, v. j.), z. Jagosh Zelenoviq. Z. Zelenoviq ka qenë prodekan i

PSSP-ja ka refuzuar ta nënshkruajë ligjin e modifikuar. Parlamentarët me këtë rast argumentojnë se ligji i aprovuar është i hapur dhe e lejon mundësinë e shkollimit universitar të serbëve në Kosovë, mirëpo nuk ka nevojë që posaçërisht në ligj të emërohet si i tillë Universiteti i Mitrovicës.

Synim i përbashkët i banorëve të Kosovës dhe i bashkësisë ndërkombëtare është që ta zhvillojë sistemin e arsimit në Kosovë dhe ta bëjë atë kompatibil me sistemet e Perëndimit, prandaj, këtu nuk ka mospajtime. Është e qartë se për momentin situata e sigurisë është e tillë që nuk mundëson integrimin fizik të serbëve të Kosovës në Universitetin e Prishtinës, dhe rrjedhimisht, propozimet e tilla duhen lënë për një kohë më të vonshme. Mirëpo, integrimi në sistem i katedrave serbe, të cilat, tash për tash, janë të vendosura në Mitrovicë, është potësisht i mundur dhe do t'u shërbentë të gjitha palëve. Në këtë mënyrë do të sigurohej shkollimi i lartë në gjuhën e tyre për pakicën serbe në Kosovë dhe në të njëjtën kohë atyre do t'u siguroheshin standarde më të larta të arsimit, të cilat janë duke u futur në Kosovë. Po ashtu, diploma që do ta merrnin do të ishte e Universitetit të Prishtinës dhe, në këtë mënyrë, ata do të kishin trajtim të barabartë si në arsimin e mëtutjeshën, ashtu edhe në tregun e punës në Kosovë dhe jashtë. Në këtë mënyrë do të sigurohej një sistem unik i arsimit në gjithë Kosovën, i cili do të zhvillohej bashkërisht. Kjo, po ashtu, do të ishte në funksion dhe do të kontribonte shumë në integrimin e të gjitha etnitetëve në shoqërinë kosovare, përfshirë këtu serbët, gjë që edhe është një ndër prioritet e bashkësisë ndërkombëtare edhe të vetë shoqërisë kosovare.

Alternativë tjetër ndaj kësaj është krijimi i një paralelizmi me dy sisteme të shkollimit të lartë në Kosovë, njërit bashkëkohor të zhvilluar në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare dhe tjetrit të dirigjuar nga Serbia që nuk përkon dhe nuk është kompatibil me atë në Kosovë. Kjo në plan afatgjatë do të ndikonte negativisht në

shoqërinë kosovare e posaçërisht në vetë serbët, të cilët pastaj do të ishin në pozitë jo të barabartë të konkurrimit si për studime të mëtutjeshme, ashtu edhe në tregun e punës.

Prandaj, zvarritja e aprovimit të Ligjit mbi Arsimin nga ana e PSSP-së vetëm sa e rëndon gjendjen dhe e lë një situatë të amullisë sa i përket shkollimit universitar. Do të ishte mirë që PSSP-ja së bashku me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Universitetit të Prishtinës dhe mësimdhënësve universitarë serbë të Kosovës të krijojnë një strategji afatgjate për integrimin e katedrave në gjuhën serbe në Universitetin e Prishtinës. Kjo do të nxiste, së fundi, integrim të plotë - edhe fizik - të mësimin në gjuhën serbe në Universitetin e Prishtinës. Kjo, po ashtu, do të ndihmonte shumë edhe në procesin gjithmbarshëm të integritit të të gjitha etnive, përfshirë edhe serbët, në shoqërinë multietnike kosovare.

XI. ORGANIZATAT E STUDENTËVE

Në Universitetin e Prishtinës ekziston një organizatë e vetme studentësh që i përfaqëson interesat e tyre në UP. Unioni i Pavarur i Studentëve (UPS), zyrtarisht, i përfaqëson studentët në strukturat universitare, si në fakultete, ashtu edhe në rektorat.

Unioni i studentëve në vitet e para të Universitetit të Prishtinës ka funksionuar si Lidhje Socialiste e Studentëve (siç ka funksionuar edhe çdo organizëm tjetër e këtij lloji në ish-RSFJ), ndërsa me shpërbërjen e sistemit monist është shndërruar në Unionin e Pavarur të Studentëve. Gjatë historikut të ekzistimit të tij, organizata studentore ka qenë nismëtare e shumë ndryshimeve në shoqërinë kosovare.

Studentët për vite të tëra kanë qenë në ballë të ndryshimeve politike e kulturore, nëpër të cilat ka kaluar shoqëria në Kosovë. Kjo ka bërë që studenti në shoqërinë kosovare të konsiderohet si një pararojë e shoqërisë, si shtresë që i fillon të gjitha proceset pozitive. Lëvizjet e viteve 1968, 1981, 1989, 1990, 1997 dhe të luftës 1998/1999, ishin të prira nga studentët.

Deri në vitin 1991, në Universitet, studentët ishin të organizuar përmes strukturave të Lidhjes së Rinisë Socialiste, por edhe në organizmat opozitarë ilegalë. Pas këtij viti strukturat e ish-sistemit filluan të shuheshin, sepse pushteti i Millosheviqit u fut në një mësymje totale ndaj institucioneve të Kosovës duke e bërë armik të vetin tërë popullin shqiptar. Ky regjim goditi edhe UP-në, të cilin e kishte halë në sy dhe i cili që nga viti 1981 nga Beogradi zyrtar cilësohej si “çerdhe e nacionalizmit shqiptar”. Pas dëbimit të arsimit shqiptar nga godinat, studentët dhe mësimdhënësit e vazhduan punën në objekte private, duke e krijuar një sistem paralel të arsimit në Kosovë.

UPS-ja është krijuar në fillim të viteve 90-të dhe ka qenë pjesë e këtij arsimit paralel dhe formë e rezistencës ndaj regjimit. Kur flitet për organizata studentore në UP, zakonisht, mendohet në UPS, sepse përpjekjet për të organizuar ndonjë organizëm tjetër serioz deri tash nuk kanë pasur ndonjë sukses të dukshëm.

Veprimtaria që e bëri të famshme UPS-në edhe në përmasa ndërkombëtare që organizimi i protestave masive studentore dhe popullore kundër regjimit të Beogradit në vjeshtë të vitit 1997 për lirinë e objekteve arsimore. Këto protesta në atë kohë qenë jo vetëm një kundërshtim i hapur e serioz i pushtetit serb në Kosovë, por edhe një rebelim brenda strukturave legale të shoqërisë së Kosovës. Këto protesta ishin edhe një përgatitje e terrenit për forcimin e rezistencës së armatosur që do të kulmonte me luftën e viteve 1998/1999.

Pas luftës në Kosovë, UP-ja ishte ndër institucionet e para që filloi të punonte. Mirëpo, UPS-ja si organizatë studentësh, megjithë ndërrimin e rrethanave shoqërore në Kosovë, vazhdoi ta paraqesë veten si mbrojtëse të interesave kombëtare. Në hulumtimin e opinionit të studentëve nga ana e kompanisë Index Kosova që është bërë në funksion të këtij studimi, rreth 32 për qind të të anketuarve mendojnë se UPS-ja është e politizuar⁶⁰.

Kjo veprimtari politike disa herë pas luftës (sidomos zgjedhjet për kryetar të UPS-së që janë mbajtur në vitin 2000) e ka sjellë në pozita të rënda krize, deri në ndërhyrje të ndërkombëtarëve, për të rregulluar situatën që krijohet brenda UPS-së, si pasojë e veprimtarive politike të individëve të ndryshëm që ishin të ndikuar nga qendra të caktuara politike. Kjo situatë vazhdon edhe sot, ndërsa UPS-ja interesat e studentëve i lë në plan të dytë, karshi angazhimeve të tyre në çështje politike.

UPS-ja, gjithashtu, është për ruajtjen e monopolit që ka në UP, ndonëse Ligji për Arsim të Lartë nuk ia jep të drejtën që ndonjë organizatë studentore të ketë monopol. Një problem real që do të dalë nga Ligji mbi Arsimin e Lartë ka të bëjë me rregullimin e mënyrës së përfaqësimit të studentëve në organet e Universitetit dhe të fakulteteve. Derisa, deri tash, UPS e ka pasur monopolin e përfaqësimit të studentëve, kjo gjë tani mund të ndryshojë në bazë të ligjit të ri dhe statutit të UP-së. Ligji nuk përcakton e UPS-në si organizatë përfaqësuese, por vetëm thekson se studentët duhet të përfaqësohen në Universitet. Duke u nisur nga qëndrimi i UPS-së që ata ta ruajnë edhe më tej këtë monopol, sigurisht që do të ketë fërkime në këtë kuadër⁶¹.

⁶⁰ Hulumtimi kuantitativ me studentë të UP, zhvilluar nga Index Kosova më 20-23 tetor 2002 në Prishtinë.

⁶¹ Ligji mbi Arsimin e Lartë, në Nenin 31, Paragrafin 1 kështu e definon këtë çështje: “Statuti ose çdo dokument tjetër themelor i bartësit të arsimit të lartë do të sigurojë krijimin e një ose më

Mënyra se si janë zgjedhur deri tash përfaqësuesit e studentëve në Unionet e Pavarura të Studentëve nëpër fakultetet e UP-së, dhe si rrjedhojë e kësaj edhe në Unionin qendror, e bën të diskutueshëm legjitimitetin e përfaqësimit të interesave të studentëve nga ana e UPS-së.⁶²

UPS-ja duhet të jetë njëra ndër organizatat studentore që do të artikulojë dhe përfaqësojë interesin e studentëve. Mirëpo, sipas zyrtarëve të lartë të UPS-së, ata me çdo kusht do të luftojnë për të mbajtur pozicionin mbizotërues në UPS-së dhe të mbeten përfaqësuesit e vetëm zyrtarë të studentëve në organet e Universitetit të Prishtinës. Kjo mund të shpjerë drejt një konflikti interesash ndërmjet UPS-së dhe Ministrisë së Arsimit.

Puna e kryer nga UPS-ja në periudhën e pasluftës nuk e ka arsyetuar sa dhe si duhet detyrën e vet. Në shumë raste UPS-ja në vend se të jetë opozitë e administratës së Universitetit dhe të fakulteteve, më shumë ka qenë zbatues i politikës së saj. Edhe pjesëmarrja e tyre në debatin për reformat e Universitetit ka qenë shumë e vogël dhe, zakonisht, qëndrimet e zyrtarëve të UPS-së kanë përkuar me qëndrimet zyrtare të rektoratit dhe të administratës ndërkombëtar. Shumë pak kreativitet intelektual dhe vizion për të ardhmen është

shumë organizatave, që të përfaqësojnë studentët dhe që të kontribuojnë në plotësimin e kërkesave sociale, kulturore, akademike e argëtuese të studentëve”.

⁶² Zgjedhjet bëhen pa fushatë paraprake, me ç’rast shumica e studentëve njoftohen me kandidatë vetëm në ditën e zgjedhjeve. Po ashtu, një numër i madh i studentëve nuk marrin pjesë në këto zgjedhje. Zgjedhjet e kohëve të fundit janë përcjellë edhe me afera për manipulime e ndonjëherë edhe me presione për dorëheqje ndaj atyre që kishin fituar. Në Fakultetin e Mjekësisë, në zgjedhjet e vitit 2000, ka pasur tentime për anulimin e votës dhe së fundi ndaj personit që ka fituar zgjedhjet është bërë presion që të japë dorëheqje, gjë të cilën fillimisht e beri dhe e bëri e pastaj tërhoqi. Në të njëjtin vit, në zgjedhjet për krytar të UPS-së në nivel qendror, ka ndërhyrë OSBE-ja (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Misioni në Kosovë) që zgjedhjet të përsëriten, për shkak të parregullsive që ishin bërë.

vërejtur në punën e UPS-së gjatë këtyre viteve të pasluftës.

Depolitizimi i UPS-së do të mund të linte më shumë hapësirë për t’i trajtuar çështjet e arsimit dhe të studimeve. Një gjë e tillë do të mund të arrihej përmes liberalizimit të sistemit të organizimit zyrtar të studentëve në Universitet, ku do të ekzistonin disa organizata konkurruese studentore, të cilat do të zgjedheshin përmes votave me fushatë të rregullt dhe transparente. Një sistem i tillë do të ndikonte si stimulim i vazhdueshëm i UPS-së dhe organizatave tjera. Lejimi i ekzistencës së degëve në Universitet të partive politike, siç është rasti në disa shtete të Perëndimit, do të ndikonte në depolitizimin e organizatave studentore.

XII. MARRËDHËNIET E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS ME UNIVERSITETET E TJERA

Përgjatë gjithë historisë së tij turbulente, Universiteti i Prishtinës ka pasur mundësi të limituara për bashkëpunim dhe shkëmbim shkencor me Universitetet e tjera nëpër botë. Mirëpo, me përfundimin e luftës në Kosovë, Universiteti, më në fund, e fitoi pothuajse lirinë e plotë për të bashkëpunuar me cilindo Universitet me të cilin ka nevojë dhe arsye për të bashkëpunuar.

Sigurisht se bashkëpunimi në mes të institucioneve shkencor-eduaktive është një domosdo që niveli i punës vazhdimisht të jetë në rritje. Kjo sidomos kur kihet parasysh se Universiteti po del nga një luftë, apartheid si dhe sundim i gjatë i komunizmit. Shkëmbimi i përvojave me universitetet e tjera nga vise të ndryshme do të thotë mjaft, sidomos, për Universitetin e Prishtinës, mirëpo edhe për vetë këto universitete. Për të reformuar dhe përmirësuar sistemin e punës së

Universitetit sigurisht se na nevojitet të mësojmë shumë nga përvojat e universiteteve me traditë më të gjatë. Po ashtu, edhe këto universitete mund të mësojnë shumë për mbijetesën e suksesshme të Universitetit të Prishtinës kundër sulmeve të vazhdueshme për ta shuar atë.

Në fazën e pasluftës, Universiteti i Prishtinës filloi të krijonte gjithnjë e më shumë kontakte. Në fillim këto ishin më shumë si rezultat i vetiniciativave të mësimdhënësve dhe të studentëve se sa i bashkëpunimit të strukturuar nëpërmjet Universitetit. Tani, sipas prof. Hajredin Kuçit, një e treta e angazhimit të rektoratit të Universitetit të Prishtinës është e angazhuar drejt këtij bashkëpunimi. Kryesisht marrëdhëniet, tash për tash, janë të fokusuar në dërgimin e kuadrove dhe studentëve për studime më të larta nëpër universitetet e jashtme. Këtu hyjnë edhe vizitat studiuere të kuadrit të angazhuar në udhëheqjen e Universitetit. Po ashtu, ekziston edhe një bashkëpunim i mirë sa i përket angazhimit dhe kontributit të profesorëve të jashtëm në mësimdhënie në Universitetin e Prishtinës.

Tash për tash, Universiteti i Prishtinës është nënshkruar i 32 marrëveshjeve bilaterale me universitete të ndryshme. Vlen të theksohen, sidomos, marrëdhëniet me Universitetet e Austrisë, Gjermanisë, Amerikës etj. Po ashtu, Universiteti i Prishtinës është anëtar në Asociacionin e Universiteteve Evropiane (ish-Konferenca e Rektorëve të Evropës), pastaj anëtar i Konferencës së Rektorëve të Danubit, e kështu me radhë. Universiteti i Prishtinës është pjesëmarrës edhe në programin TEMPUS, ku edhe është treguar shumë i suksesshëm. Një indikacion për këtë është shembulli i vitit të kaluar, kur nga 9 projektet e dorëzuara me një shumë prej mëse 1 milion eurosh, të gjitha u aprovuan.⁶³

Një ndër qëllimet e bashkëpunimit të Universitetit të Prishtinës me qendrat e ndryshme ndërkombëtare ishte edhe fitimi i përkrahjes morale dhe njohjes së Universitetit, i cili ishte i shtypur për shumë vite. Kjo gjë është arritur në masë të madhe dhe tani pothuajse të gjitha universitetet në botë i pranojnë diplomat e Universitetit të Prishtinës. Përveç përkrahjes morale, përkrahjes në ngritjen e kapacitetit të kuadrit të Universitetit, bashkëpunimi ka ndihmuar mjaft edhe në infrastrukturë. Brenda tre vjetësh të pasluftës, ndjehet një përmirësim i dukshëm në pajisjen dhe kushtet e punës në Universitet.

Si pasojë e këtij bashkëpunimi, deri më tash, krahas atyre që kanë shkuar personalisht me vetiniciativë, përmes Univerzitetit janë dërguar rreth 400 studentë në specializime të mëtutjeshme. Nga ky numër më shumë kanë përfitur shkencat shoqërore, mirëpo të gjitha fakultetet janë të përfshira.

Po ashtu, ka qenë edhe numri mjaft i madh i profesorëve dhe i kuadrit shkencor të Universiteteve të jashtme që nëpërmjet këtij bashkëpunimi kanë ndihmuar në punën e Universitetit të Prishtinës. Në disa fakultete edhe është përdorur sistemi i bashkëligjerimit, me një ligjërues nga Kosova dhe një ligjërues të huaj. Në këtë mënyrë kanë përfitur edhe ligjëruesit, por sidomos studentët, të cilët kanë pasur mundësi të dëgjojnë përvoja të ndryshme si dhe të provojnë sistemet e ndryshme të ligjërimit.

Mirëpo, bazuar në diskutimin e fokus grupit të mësimdhënësve⁶⁴, është thënë se element negativ në lidhje me këtë është mosinteresimi i kuadrit për projektet e ofruara nga bashkëpunimi me jashtë, sidomos ato projekte që janë implementuar në Kosovë. Këtu hyjnë trajnime të ndryshme, seminare, takime konsultative

⁶³ Intervistë me z. Hajredin Kuçin, prorektor për marrëdhënie me jashtë pranë Universitetit të Prishtinës, realizuar në tetor 2002.

⁶⁴ Hulumtimi kualitativ me mësimdhënës të UP-së, zhvilluar nga Index Kosova, më 5 nëntor 2002, në Prishtinë.

ndërmjet mësimdhënësve vizitues dhe kuadrit e studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Përpos Universitetit, ekzistojnë edhe disa skema të tjera, të cilat u mundësojnë studentëve kosovarë që të ndjekin studime në qendrat ndërkombëtare. Shumica nga to janë të fokusuar në studime postdiplomike dhe kryesisht në shkencë shoqërore. Ndër to janë edhe bursa "British Chevening" e ofruar nga zyra e Këshillit Britanik në Prishtinë, pastaj programi "Ron Brown" i ofruar nga zyra e SHBA-së në Prishtinë, si dhe disa programe të tjera që ofrohen nga përfaqësitë e vendeve të ndryshme në Prishtinë. Vlen të theksohet edhe rifillimi i programit "Fulbright" i ofruar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili ishte ndërprerë në fillim të viteve të nëntëdhjeta.

Mirëpo, të gjitha këto programe janë mjaft të kufizuara për sa i përket numrit të studentëve që mund të përfitojnë. Nëse marrim për shembull bursën "British Chevening", ajo u ofrohet 8 personave nga Kosova të diplomuar në Universitet në fushat respektive: ekonomia dhe financat, drejtësia, menaxhimi, mediumet, qeverisja etj. Edhe programet e tjera që ofrohen për studime postdiplomike janë të ngjashme me këtë.

Një fushë tjetër e bashkëpunimit që duhet t'i jepet shumë rëndësi është bashkëpunimi me universitetet shqiptare në Shqipëri dhe IRJM. Bashkëpunimi me universitetet në Shqipëri ka qenë mjaft i lartë dhe i rëndësishëm, sidomos gjatë viteve të nëntëdhjeta, kur Universiteti i Prishtinës punonte në kushte të apartheidit. Mirëpo, tani ky bashkëpunim duhet të zgjerohet duke shikuar mundësi të reja të bashkëpunimit, sikur shkëmbimi i kuadrit mësimdhënës si dhe i studentëve. Në një të ardhme të mesme, po ashtu, ky bashkëpunim do të mund të shikohej edhe nga prizmi i specializimeve në fusha të

caktuara të universiteteve të ndryshme shqiptare. Ky trajtim racional do ta mundësonte ngritjen e nivelit shkencor dhe teknologjik në qendrat përkatëse, të cilat pastaj studentët do të mund t'i shfrytëzonin për zhvillim më të lartë.

Një problem është që personat, të cilët kryejnë studime në universitetet e Perëndimit do të kenë mundësi dhe kushte më të mira po që se mbeten në ato vende. Kjo është një humbje e madhe si për Universitetin e Prishtinës, ashtu edhe për shoqërinë kosovare në përgjithësi.

Prandaj, është shumë me rëndësi që individët e specializuar në fusha të ndryshme të kthehen në Kosovë dhe atyre t'u ofrohen mundësi dhe kushte pas kthimit këtu. Sigurisht se një numër i tyre do të angazhohen në Universitetin e Prishtinës, mirëpo pjesa tjetër nuk do të ketë mundësi që të angazhohen në këtë mënyrë. Po ashtu, ekziston edhe nevoja për angazhimin e tyre edhe në mënyra të tjera. Prandaj, duhet që Qeveria e Kosovës të parashohë një pjesë të buxhetit për përkrahjen e institucioneve të ndryshme shkencore, në të cilat do të punonin e angazhoheshin këta individë. Këto institucione do të ishin edhe ndihmesë e madhe për qeverisjen e Kosovës në përgjithësi.

Në çdo fakultet do të duhej të krijohet një zyrë këshilluese për studentët dhe mësimdhënësit ashtu që të shtohet niveli i informimit të personave të interesuar. Në këtë mënyrë edhe do të thellohej ky bashkëpunim në fusha të ndryshme. Sipas zyrtarëve në Universitet, është me rëndësi që bashkëpunimi të jetë vazhdimësi e punës të filluar më herët nga ndonjë punëtor shkencor i Universitetit. Kjo zyrë do të ofronte informacione lidhur me mundësitë e bashkëpunimit si dhe informata praktike mbi kushtet dhe mënyrën e aplikimit.

ANEKSI A

Anëtarët e Grupit për Zgjidhje Logjike

Ardian Jashari

Artor Sejfi

Bardh Rugova

Bersant Disha

Besnik Pula

Dritan Gjonbalaj

Kreshnik Berisha

Valon Murati

Visar Berisha

Për më shumë informata mbi KIDS-in apo LOGO-n, mund të na kontaktoni në:

Iniciativa e Kosovës për Shoqëri Demokratike

Projekti LOGO

Rr. Sylejman Vokshi 2/2

Prishtinë

Kosovë

Tel/fax: + 381 38 224 650

e-mail: kids_pri@hotmail.com

web-site: www.kids-kosova.org